Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2020

ABSTRAKT
Ky Raport Vjetor i Punës së Agjencisë Kundër Korrupsion paraqet përmbledhjen e aktiviteteve, të arriturat dhe sfidat për vitin 2020

Prishtinë, mars 2021

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT 5
Korniza ligjore 5
Organizimi i brendshëm 6
DEPARTAMENTI PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT 8
Zbatimi i ligjit 8
Zhvillimi i hetimeve 8
Rastet e paraqitura në AKK për vitin 2020 8
Rastet e përcjella te institucionet kompetente për procedim 9
Personat e dyshuar për veprime korruptive 9
Rastet e përcjella sipas strukturës së veprave penale 10
Karakteristikat e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimeve paraprake 12
Rastet e përcjella sipas vitit të kryerjes së veprimit të dyshuar korruptiv 14
Pushimi i hetimeve dhe hedhja poshtë e rasteve 14
Aspekte rreth trajtimit të rasteve në gjykatë gjatë vitit 2020 14
Rastet e mbyllura 15
Zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve 16
Raport lidhur me Kërkesat për fillimin e procedurës së kundërvajtjes dhe rastet e sinjalizimit të jashtëm, për vitin 2020 16
Rasti I 16
Rasti i II, IV dhe V 17
Rasti-III 17
Raportet nga institucionet publike, subjektet private, si dhe rregullatorët lidhur me sinjalizimin 17
Strategjia dhe Plani i Veprimit 21
DEPARTAMENTI PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT 23
Deklarimi i pasurisë, kontrolli i pasurisë dhe deklarimi i dhuratave 23
Llojet e deklarimit të pasurisë 23
Kontrolli i deklarimit të pasurisë 25
Katalogu i dhuratave 26
Dorëzimi i katalogut të dhuratave 26
Parandalimi i korrupsionit në prokurimin publik 27
Rastet e protokolluara - informacionet 28
Rastet e monitoruara - informacionet 28
DEPARTAMENIT I PARANDALIMIT TË KONFLIKTIT TË INTERESIT 29
Aktivitetet vetëdijësuese të departamentit për parandalimin e konfliktit të interesit 32
MBËSHTETJA PROFESIONALE DHE BASHKËPUNIMI 33
AKTIVITETET JURIDIKE 33
Mbështetja profesionale juridike dhe legjislacioni 33

Përfaqësimi i rasteve 33
Përfaqësimi i Agjencisë në takime të ndryshme 34
Menaxhimi i Teknologjisë Informative 34
Arkiva 35
KOMUNIKIMI PUBLIK 38
Zbatimi i ligjit për qasje në dokumente publike 39
Monitorimi i mediave 39
MENAXHIMI I PERSONELIT 41
Prokurimi 42
BUXHETI (PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE KRYESORE) 43
BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET TJERA QË KANË PËR MISION LUFTIMIN DHE PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT 44
ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA) 46
MËSIMET DHE REKOMANDIMET 47
PËRFUNDIMI 49
SHTOJCAT 52
TABELA E TRAJNIMEVE 53

Lista e Shkurtesa

AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
ARBK	Agjencia për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
ARC	Agjencia e Regjistrit Civil
BE	Bashkimi Europian
D+	Organizata joqeveritare Demokracia Plus
DSAK	Departamenti Special Anti-Korrupsion
DHKEK	Drejtoria për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, Policia
NjIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
GSJP	Grupi për Studime Juridike dhe Politike
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJTH	Gjykata Themelore
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IKD	Instituti Kosovar për Drejtësi
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KDI	Kosovo Democratic Institute
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror Zgjedhor
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LDC	Leadership and Development Consultancy
MAP	Ministria e Administratës Publike
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MDA	Menagment Development Association
MF	Ministria e Financave
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dh Industrisë
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
OE	Operator Ekonomik
OSBE	Organizata për Siguri dhe bashkëpunim në Europë
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PK	Policia e Kosovës
PPK	Prokuroria Publike Komunale
PPQ	Prokuroria Publike e Qarkut
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PSH	Prokuroria e Shtetit
PTH	Prokuroria Themelore
QKSPEZH	Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim
RAI	Regional Anti-Cooruption Initiative
SPV	Strategjia dhe Plani i Veprimit Agjencisë kundër Korrupsionit
TI	Transparency International
UNDP	United Nations Development Program
UP	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
USAID	United States Aid for International Development
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZMBI	Zyra për Marrëdhënie, Bashkëpunim dhe Informim
ZPD	Zyra e Prokurorit Disiplinor

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në mbështetje të Nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Agjencia paraqet Raportin Vjetor të Punës për vitin paraprak tek Kuvendi i Republikës së Kosovës, pranë Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit. Qëllimi i Ky Raport Vjetor i Punës së Agjencisë Kundër Korrupsion paraqet përmbledhjen e aktiviteteve, të arriturat dhe sfidat e AKK-së për vitin 2020.

Aktivitetet në të cilat është përqendruar ky raport janë si në vijim:

- ⇒ Zbatimi i kornizës ligjore në fushën e kundër korrupsionit;
- ⇒ Rezultatet nga procesi i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe regjistrimi i dhuratave të pranuara, publikimi i regjistrave të formularëve të deklarimit të pasurisë nga zyrtarët e lartë publik në web-faqen zyrtare të AKK-së;
- ⇒ Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të konfliktit të interesit gjatë dhe pas ushtrimit të funksionit publik të zyrtarëve të lartë publik dhe zyrtarëve të tjerë;
- ⇒ Rezultatet e parandalimit të korrupsionit gjatë monitorimit të aktiviteteve në prokurimin publik;
- ⇒ Zbatimi i ligjit dhe trajtimi i rasteve në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve;
- ⇒ Përcjellja e kallëzimeve penale në prokuroritë kompetente, përcjellja e kërkesave për fillimin e procedurës disiplinore për shkeljet e dyshuara administrative;
- ⇒ Edukimi i zyrtarëve publik dhe aktivitetet vetëdijësuese për qytetarëve mbi kornizën ligjore dhe mekanizmat aktual përgjegjës për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Raporti Vjetor i Punës paraqet përpjekjet e institucionit në parandalimin dhe luftimin e rasteve të korrupsionit si dhe vetëdijesimin e publikut me qëllim të krijimit dhe promovimit të rendit dhe sundimit të ligjit. Ky raport pasqyron po ashtu raportet e Agjencisë dhe institucioneve tjera, sidomos me ato të zbatimit të ligjit, në drejtim të përcaktimit të prioriteteve të qarta për zbatimin e kornizës ligjore me qëllim - luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, promovimin e transparencës dhe forcimin e integritetit institucional.

Përkundër përkushtimit maksimal në përmbushjen e mandatit, AKK konsideron se situata me pandeminë COVID-19, masat e Qeverisë së miratuara për kufizim të stafit, kufizim të lëvizjes, dhe koordinimi i punëve, në disa raste dhe me orar të shkurtuar, sikurse për të gjitha institucionet tjera publike, ka ndikuar edhe në mbarëvajtjen e punës së AKK-së. Megjithatë, shumica e zyrtarëve kanë rezultuar pozitiv, dhe kanë kaluar me sukses, dhe falë kujdesit, AKK ka arritur që të menaxhoj mirë dhe t'i përshtatet rrethanave, duke filluar me përdorimin e teknologjisë informative, duke i zëvendësuar takimet e rregullta me ato online (virtuale). Të gjithë këto kanë rezultuar në progresin e kënaqshëm në realizimin e detyrave të AKK-së, dhe arritjen e rezultateve si të paraqitura në këtë raport.

Për qëllimet e raportimit, Raporti Vjetor i Punës mbulon periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2020.

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, AKK është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Agjencia është themeluar në korrik të vitit 2006, ndërsa është funksionalizuar më 12 shkurt 2007.

Fushëveprimi i Agjencisë është i përqendruar në hetimet dhe aspektet administrative. Këtë mandat AKK e realizon përmes procesit të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, deklarimit dhe regjistrimit të dhuratave të zyrtarëve publik, parandalimit të rasteve të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik, hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, hetimin dhe zbulimin e rasteve me natyrë të korrupsionit, mbrojtjen e sinjalizuesve, përpjekjet për parandalimin e fenomenit të korrupsionit si dhe vetëdijesimin e publikut në hapat progresiv drejt krijimit të një shoqërie ku sundon rendi dhe ligji.

Legjislacioni aktual kundër korrupsionit, mbi bazën e të cilit AKK edhe i zhvillon aktivitetet e saj parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve paraprake të korrupsionit, në mbrojtjen e sinjalizuesve, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, jo pajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e detyrës zyrtare, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publik.

Korniza ligjore

Gjatë realizimit të mandatit dhe ushtrimit të kompetencave, AKK bazohet në kornizën ligjore primare dhe sekondare.

Korniza ligjore primare bazike, por që nuk kufizohet vetëm, sipas së cilës AKK realizon mandatin është si në vijim:

- Ligji Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit;
- Ligji Nr. 04-L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar;
- Ligji Nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04-L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të personat zyrtar;
- Ligji Nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
- Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Aktet nën-ligjore në bazë të të cilave është organizuar puna e AKK dhe të cilat janë të miratuara nga AKK janë si në vijim:

- Rregullore Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit;
- Kodi Nr. 03/2013 i etikës për nëpunësit e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Rregullore Nr. 01/2014 e punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Rregullore Nr. 02/2014 për organizimin, funksionalizimin dhe menaxhimin e arkivit të Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Rregullore Nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 e punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Rregullores Nr. 01/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Organizimi i brendshëm

Agjencia ka të punësuar 43 zyrtarë, duke përfshirë Drejtorin e Agjencisë. Organizimi i brendshëm është i rregulluar me Rregulloren Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Rregullores Nr. 01/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Sipas kësaj Rregullore, Agjencia është e ndarë në këto departamente dhe divizione:

1. **Departamenti për Luftimin e Korrupsionit** është përgjegjës për zhvillimin e procedurave të hetimit paraprak të rasteve të dyshimit për korrupsion, analizimin e të dhënave statistikore dhe të dhënave të tjera për gjendjen e korrupsionit në Kosovë, hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, mbrojtjen e sinjalizuesve sipas ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve si dhe raportimin për zbatimin e detyrave të Agjencisë të përcaktuara nga dokumentet tjera strategjike. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Hetime dhe Analiza, 2. Divizioni për Hetime dhe Strategji, dhe 3. Divizioni për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.
2. **Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit** është përgjegjës për mbikëqyrjen e pasurisë, mbikëqyrjen e dhuratave dhe parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik dhe korrupsionit në tërësi. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Deklarimin e Pasurisë dhe Dhuratave dhe 2. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik.
3. **Departamenti për Parandalimin e Konfliktit të Interesit** është përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik gjatë ushtrimit të funksionit publik, bashkëpunon me Autoritetet Përgjegjëse, merret me analizimin dhe trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, pranon raportet vjetore nga Autoritetet Përgjegjëse, ofron asistencë profesionale dhe këshilla për institucionet tjera në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për Zyrtarë të Lartë dhe Autoritete Përgjegjëse, dhe 2. Divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për Autoritete Përgjegjëse dhe Personat Zyrtarë.

4. **Departamenti për Financa dhe Punët të Përgjithshme** është përgjegjës për menaxhimin dhe përkujdesjen për burimet materiale, ofrimin e shërbimeve administrative, menaxhimin e financave dhe buxhetit si dhe logjistikën e Agjencisë. Ky Departament është i përbërë nga Divizioni për Shërbime të Përgjithshme, Buxhet dhe Financa.

5. **Zyrën për Mbështetje dhe Bashkëpunim** është përgjegjës për ofrimin e mbështetjes profesionale, për menaxhimin dhe administrimin e të dhënave elektronike të agjencisë dhe të sistemit të TI-së, dhe çështjet tekniko-administrative dhe arkivimin e shkresave zyrtare.

6. **Koordinatori i Zyrës për Komunikim me publikun** organizon, koordinon, drejton dhe bashkërendon aktivitetet lidhur me informimin e publikut dhe mediave përkitazi me punën, aktivitetet dhe veprimtarinë e Agjencisë.

7. **Menaxheri i personelit** dhe **Menaxheri Prokurimit** përgjegjës për proceduat e rekrutimit, për menaxhimin e disa aktiviteteve të prokurimit.

Organogrami i AKK është paraqitur në mënyrë grafike në *Shtojcën I*.

Në kuadër të AKK-s konform dispozitave ligjore të shërbimit civil dhe zyrtarëve publik është i themeluar: Komisioni Disiplinor. Ky komision nuk ka pranuar asnjë kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore gjatë vitit 2020. Ndërkaq, Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave ka qenë funksional deri në hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik. Deri në këtë periudhë nuk ka pranuar asnjë ankesë.

DEPARTAMENTI PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe legjislacionit sekondar, Departamenti për Luftimin e Korrupsionit në kuadër të AKK-së fushë-veprimtarinë e saj e kryen përmes (1) zbatimit të kornizës ligjore dhe zhvillimit të hetimeve paraprake, (2) zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe (3) hartimit dhe monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit.

Zbatimi i ligjit

Në kuadër të AKK, përgjegjës për aspektet e zbatimit të Ligjit është Departamenti për Luftimin e Korrupsionit, i cili në kuadër të veprimtarisë së tij organizon këto aktivitete:

- ⇒ Zhvillimin e hetimeve paraprake lidhur me dyshimet e supozuara për korrupsion në ato raste kur nuk iniciohet procedurë penale nga ndonjë mekanizëm tjetër;
- ⇒ Përcjelljen e rasteve të hetuara tek prokuroria publike kompetente për procedim penal të mëtutjeshëm, si dhe përcjelljen e kërkesave për fillimin e procedurës disiplinore në lidhje me rastet e dyshuara për shkelje administrative;
- ⇒ Trajtimin e rasteve të sinjalizimit – sinjalizimi i jashtëm i përcaktuar me Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe ofrimi i asistencën profesionale për Zyrtarët Përgjegjës për Sinjalizim të caktuar nga institucionet publike;
- ⇒ Bashkëpunimin me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare të ngarkuara për zbatimin e ligjit gjatë procedurave hetimore që kryhen nga këto autoritete.

Zhvillimi i hetimeve

Prioritet i Departamentit për Luftimin e Korrupsionit gjatë kësaj periudhe raportuese ka qenë pranimi, inicimi sipas detyrës zyrtare dhe hetimi paraprak i rasteve të dyshuara të korrupsionit. Si rrjedhojë janë hetuar raste të raportuara nga qytetarët, po ashtu edhe raste të cilat janë iniciuar sipas detyrës zyrtare kur AKK ka ardhur deri te informacionet e bazuara për veprime korruptive të mundshme.

Sa i përket rasteve të hetuara me dyshimin për veprime korruptive, si dhe lidhur me vendimet finale gjatë kësaj periudhe raportuese, në vijim do të japim pasqyrën e përgjithshme.

Rastet e paraqitura në AKK për vitin 2020

AKK gjatë vitit raportues nga qytetarët ka pranuar informacione në lidhje me dyshimet për veprime korruptive përmes mënyrave të ndryshme të raportimit. Qytetarët mund të raportojnë rastet e dyshuara për korrupsion në disa mënyra të raportimit. Raportimi i drejtpërdrejtë përmes linjës telefonike pa pagesë **0800 10 800**, raportimi përmes postës dhe përmes e-mailit (formës online) nga www.akk-ks.org. Për personat të cilët me mirëbesim kanë zbuluar informacionin për ekzistencën e korrupsionit dhe me qëllim të pengimit të pasojave të dëmshme ndaj tyre, AKK ka mundësuar që ata t'i paraqesin rastet e dyshuara të korrupsionit në mënyrë anonime me qëllim

të ruajtjes së identitetit të raportuesve dhe inkurajimin e qytetarëve për raportimin e këtyre rasteve.

Gjatë vitit 2020, AKK ka zhvilluar procedurën e hetimeve paraprake në gjithsej 313 raste, prej të cilave 134 janë bartur nga viti paraprak, kurse gjatë vitit 2020 janë pranuar edhe 179 raste. Prej tyre 124 raste, janë përcjellë në Prokurori, Polici për procedim të mëtutjeshëm, 16 raste janë përcjellë në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore, 112 raste janë mbyllur, ndërsa 61 raste janë në procedurë. Numri i përgjithshëm i informacioneve anonime të trajtuara është 19. Gjatë vitit raportues Agjencia ka trajtuar gjithsej 66 raste të iniciuara sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*). Grafiku i mëposhtëm *(Figura 1)* pasqyron procedimin e 313 rasteve të trajtuara gjatë vitit 2020.



Figura 1. Paraqitja grafike e procedimit të rasteve të trajtuara gjatë vitit 2020

Rastet e përcjella te institucionet kompetente për procedim

Gjatë periudhës raportuese në institucionet kompetente për procedim të mëtutjeshëm janë përcjellë 124 kallëzime penale dhe informata.

Prej tyre në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit janë përcjellë 95 kallëzime penale dhe 16 informata, për të cilat Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka njoftuar se ato janë deleguar në kompetencë të prokurorive respektive.

Në DHKEK janë përcjellë 13 informata.

Në 16 raste, pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake, është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale, por është dyshuar për shkelje administrative. Agjencia këto raste i ka përcjellë tek organet kompetente administrative me kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore.

Personat e dyshuar për veprime korruptive

AKK, në 124 rastet e përcjella në Prokurori dhe Polici të Kosovës për procedim të mëtutjeshëm penal pas konstatimeve se ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm për

përfshirjen në veprime korruptive, ka denoncuar 180 persona. Prej tyre 172 janë përcjellë në Prokurori dhe 8 persona në DHKEK- Policia e Kosovës.

AKK gjithashtu gjatë periudhës raportuese ka përcjellë 16 raste në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore kundër 25 personave zyrtarë të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Në vijim figura 2, pasqyron në mënyrë grafike numrin e kallëzimeve penale, informatave dhe kërkesave për fillim të procedurës disiplinore dhe numrin e personave të përfshirë për rastet që janë referuar te institucionet përkatëse.



Figura 2. Pasqyrimi i numrit të rasteve dhe numrit të personave të përcjellë te institucionet përkatëse

Rastet e përcjella sipas strukturës së veprave penale

Në mesin e 124 rasteve të përcjella në Prokurori, DHKEK- Policia e Kosovës për procedim të mëtutjeshëm, në disa prej tyre janë të përfshira dy e më shumë vepra penale. Veprat penale i përkasin kryesisht kapitullit XXXIV Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare sipas Kodit Penal të Kosovës. Ndërsa në 24 raste (14 DHKEK dhe 10 në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit), për veprimet e dyshuara nuk është arritur që të kualifikohen se çfarë figure të veprës penale paraqesin, për shkak të tejkalimit të mundësisë dhe kompetencës hetimore të Agjencisë.

Struktura e veprave penale të përcjella në institucionet kompetente dhe niveli i zyrtarëve të dyshuar, është si në vijim:

- ⇒ Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare - Numrin më të madh të rasteve të përcjella në Prokurori e përbëjnë veprimet e sanksionuara sipas nenit 437 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës, përkatësisht neni 430 sipas Kodit nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës (i cili ka hy në fuqi me datë 14 prill 2019).
- ⇒ Keqpërdorimi i Pozitës apo autoritetit zyrtar - Nga numri i përgjithshëm i rasteve të përcjella në Prokuroritë dhe DHKEK- Policia e Kosovës, numrin e dytë më të madh të tyre

e përbëjnë veprimet korruptive të parapara sipas nenit 422 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës, përkatësisht nenit 414 të Kodit nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës. Në një rast kjo vepër penale është shoqëruar edhe me veprën penale të Mashtrimit (neni 335 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës), Falsifikimi i dokumentit zyrtar (neni 434 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës) dhe Shmangia nga tatimi (neni 313 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës), ndërsa në një rast tjetër është shoqëruar me veprën penale Konflikti i Interesit (neni 424 i Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës).

⇒ Mashtrimi - të ngarkuar me këtë vepër penale e cila është e përcaktuar në nenin 335 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Kosovës janë përcjellë 2 raste.

⇒ Konflikti i interesit - Sipas kësaj vepre penale të përcaktuar në nenin 417 të Kodit nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës) në Prokurorinë kompetente është përcjellë 1 rast.

Personat e përfshirë në këto raste i përkasin niveleve të ndryshme si: ministra, zëvendës ministra, kryetar dhe nënkryetar komunash, gjyqtar, shefa të kabineteve të kryeministrave, shefa të kabineteve të ministrave, këshilltarë politik të ministrave, shefa kabineti të kryetarëve të komunave, sekretar të përgjithshëm në nivel qendror, këshilltarë në ambasada, këshilltarë, ish këshilltar të asambleve komunale, kryesues, anëtarë të këshillave drejtues në universitete publike, rektor, ish rektor, ish prorektorë, prodekanë në fakultete të universiteteve publike, sekretar, ish sekretar të universiteteve publike, kryeshef, ish kryeshef ekzekutiv apo drejtorë të agjencive ekzekutive në kuadër të ministrive, anëtarë të këshillave drejtues të institucioneve vartëse në kuadër të ministrive, drejtorë departamentesh në institucione jashtë qeveritare, drejtor departamentesh në ministri, drejtor drejtorie në komuna, menaxherë të prokurimit, nëpunës komunal, asistent administrativ në nivel lokal, certifikues, shpenzues, zotues, autorizues e zyrtar kryesor financiar në nivel qendror, drejtor spitalesh, drejtorë klinikash, aksionar të ndërmarrjeve publike lokale, anëtarë, ish anëtar bordesh të ndërmarrjeve publike, kryeshefa, ish kryeshefa ekzekutiv të ndërmarrjeve publike lokale, pronar të bizneseve të caktuara, drejtor i OJQ-së, etj.

Pas zhvillimit të procedurës së hetimeve paraprake, Agjencia gjatë periudhës raportuese ka nxjerrë opinione, rekomandime, përgjigje- mendime profesionale, kërkesa dhe delegim në kompetencë, të cilat i ka adresuar tek institucionet relevante në Republikën e Kosovës, si në vijim:

- Opinion me propozim që të iniciohen/ndërmerren nisma ligjore për rregullimin e çështjes së pavarësisë së funksionimit të një Ndërmarrje Publike duke ua ndaluar dhe pamundësuar drejtorëve të zgjedhur/emëruar në borde të ndërmarrjeve publike angazhimin eventual në parti politike, si bartës të një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike, si dhe të emërohen, ose propozohen nga subjekti politik si kandidat për një post të zgjedhur.
- Opinion që çështja e emërimeve e më pak se 1/3 të anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim pa ftesë publike dhe pa raportim Kuvendit të Kosovës nga Ministri përkatës duhet të ndërpritet.
- Opinion për ndërmarrjen e masave për rregullim/kontroll më rigoroz sa i përket angazhimit të personelit/mësimdhënësve në marrëdhënie të rregullt pune në universitete

publike, që sipas statuteve nuk mund të kenë kontratë tjetër të punësimit me normë të plotë në ndonjë Universitet tjetër.

- Rekomandime për udhëheqësit e institucioneve që të marrin masa në mënyrë që të mos përsëriten situatat kur zyrtarët kontaktues me AKK-në nuk i përcjellin njoftimet te zyrtarët e lartë publik rreth procesit të deklarimit të pasurisë.

Sa i përket 16 rasteve të përcjella me kërkesa për fillim të procedurave disiplinore nga ana e AKK-së, institucionet kompetente administrative në 2 raste kanë shqiptuar masën disiplinore vërejtje verbale, ndërsa në 1 rast kanë shqiptuar vërejtjen disiplinore pezullim i ushtrimit të detyrave dhe ndalim i 1/3 të pagesës për 1 muaj, 1 rast është pezulluar për shkak të zhvillimit të procedurës penale dhe 1 rast është premtuar shtim i kontrollit përderisa për 11 raste të tjera AKK nuk ka marr ndonjë informatë.

Karakteristikat e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimeve paraprake

AKK ka zhvilluar procedurën e hetimeve paraprake në lidhje me dyshimet për veprime korruptive, pra në lidhje me veprat penale nga kapitulli XXXIV i KPK-së - Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare. Përkundër një angazhimi të përgjithshëm institucional veprat penale të korrupsionit vazhdojnë të përbëjnë numrin më të vogël të veprave të hetuara nga organet e ndjekjes, por njëkohësisht përbëjnë edhe veprat penale për të cilat më së paku janë shqiptuar dënime.

Karakteristikë e rasteve të hetuara që kanë të bëjnë me veprën penale *Keqpërdorim i Pozitës apo autoritetit zyrtar* nga neni 422 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovë, përkatësisht neni 414 të Kodit nr. 06/L-074, është shfrytëzimi i detyrës apo autoritetit zyrtar nga personi zyrtar i cili me veprim apo mosveprim shkel ligjet e aplikueshme me qëllim përfitimi të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, apo me qëllim të shkaktimit të dëmit për personat tjerë apo biznesin e caktuar, ose që seriozisht shkel të drejtat e personit tjetër, tejkalon kompetencat dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare.

Veprimet apo mos veprimet e përmendura i referohen shkeljeve si:

- Realizimi i shpenzimeve duke mos zbatuar procedurat e prokurimit;
- Subvencionim pa plotësuar kushtet e përcaktuara ligjore dhe shmangie nga tatimi nga biznese të caktuara;
- Mbështetje financiare jashtë fushëveprimit të institucionit;
- Marrja pjesë në takime vlerësuese si anëtar komisioni për vlerësim duke vlerësuar edhe projektin e vet;
- Dhënie e pronave në shfrytëzim pa procedura ligjore të parapara me legjislacionin në fuqi;
- Investitorët për tu pajisur me leje ndërtimore, projektin e ndërtimit duhet ta bëjnë te kompania e caktuar, ku pronar është ish bashkëpunëtori i Drejtorit të Urbanizmit;
- Dhënie e kompetencave shtesë stafit politik- këshilltarëve përmes rregullores për funksionim të kabinetit të Ministrit në mbikëqyrjen e punëve të shërbyesve civil dhe projekteve të caktuara në kundërshtim me rregulloren e Qeverisë;
- Përzgjedhje e drejtorëve të shkollave në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
- Angazhim i personave në marrëdhënie pune pa shpallur konkurs dhe jashtë strukturës organizative dhe asaj të lejuar nga Ministria përkatëse;

- Punësimi i stafit politik në shërbimin civil dhe mundësimi i pezullimit të kësaj pozite në shërbimin civil për ushtrimin e funksionit politik;
- Angazhim në të njëjtën kohë në dy pozita në institucione të ndryshme në orar të plotë;
- Punësime në baza politike dhe nepotizmi;
- Përshtatje e kushteve të konkursit personave të caktuar;
- Punësim në shërbimin civil pa mbajtur fare testim me shkrim;
- Punësim pa i plotësuar kushtet e kërkuara me konkurs;
- Avancim në kundërshtim me legjislacionin në fuqi duke mos plotësuar kushtet e kërkuara për atë pozitë;
- Transferim i përhershëm nga një pozitë në pozitën tjetër në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
- Rekomandim i kandidatit për drejtor bordi në ndërmarrje publike në kundërshtim me ligjin;
- Paraqitje e rrem e deklaratës nën betim duke fshehur faktin se kinse nuk është i punësuar ndonjë anëtar i familjes në po atë institucion;
- Paraqitje e rrem e deklaratës nën betim duke fshehur faktin se kinse nuk ka qenë i emëruar politik brenda tri viteve të kaluara sipas ligjit për ndërmarrjet publike;
- Pagesa për nëpunës të caktuar edhe pse të njëjtit nuk paraqiten fare në punë dhe pagesë për persona të cilët ju ka përfunduar mandati;
- Pagesa shtesë jashtë pagës bazë me arsyetime të punëve jashtë orarit të rregullt të punës, ditëve të vikendit apo festave zyrtare;
- Shfrytëzim i kundërligjshëm i veturave dhe drekave zyrtare;
- Aprovimi i pagesave të ndryshme për aktivitete të cilat nuk janë kryer.

Siç shihet edhe nga të lartcekurat vepra penale Keqpërdorim i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar është karakterizuar kryesisht me shkelje të rregullave të rekrutimit (punësimit), sistemimeve, transfereve dhe avancimeve. Të njëjtat shkelje e karakterizojnë këtë vepër penale edhe në rastet kur kjo vepër penale është shoqëruar edhe me vepra tjera penale.

Disa veprime tjera të cilat e karakterizojnë këtë vepër penale për shkak të natyrës së tyre nuk janë prezantuar për faktin se publikimi i tyre do të mund të dëmtonte procesin e mëtutjeshëm të hetimeve.

Konflikti i Interesit - nga neni 417 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovë, kjo vepër penale është karakterizuar me marrjen pjesë të personave zyrtar personalisht në çështje zyrtare të caktuar duke i mundësuar përfitim financiar vetes përmes nxjerrjes së vendimeve.

Mos deklarimi ose deklarimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare - nga neni 437 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovë, përkatësisht 430 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovë. Karakteristikë e rasteve të hetuara të cilat kanë të bëjnë me këtë vepër penale është mos deklarimi i pasurisë brenda afateve të përcaktuara kohore sipas ligjit në fuqi (sipas deklarimit të rregullt vjetor, deklarimit me marrjen e detyrës, deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni) dhe mosparaqitja e të dhënave të kërkuara si paluajtshmëria, pasuria e luajtshme në vlerë mbi tremijë (3000) Euro, zotërimi i aksioneve në shoqëri tregtare apo të hyrave vjetore.

Rastet e përcjella sipas vitit të kryerjes së veprimit të dyshuar korruptiv

Në periudhën raportuese, rastet për të cilat gjatë hetimeve AKK ka gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive e të cilat janë përcjellë për procedim penal të mëtutjeshëm në institucionet kompetente, i takojnë viteve të ndryshme të kryerjes së tyre, duke filluar nga viti 2012-2020.

Pushimi i hetimeve dhe hedhja poshtë e rasteve

AKK ka vazhduar të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e zbatimit të ligjit. Prokuroria e Shtetit, në bazë të mandatit të saj ka vazhduar të kërkojë prova shtesë për të shkuar përtej dyshimit të arsyeshëm dhe të bazuar në lidhje me konstituimin e elementeve të veprës penale. Gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur progres dukshëm në raport me kallëzimet penale të AKK-së, por se në disa raste, Prokuroritë kanë hedhur poshtë kallëzimet penale apo kanë pushuar hetime për një numër të rasteve.

Dispozitat ligjore në fuqi parashohin rastet e pushimit të hetimeve dhe hedhjes poshtë të rasteve të iniciuara në fazën e hetimeve. Rastet janë hedhur poshtë nga Prokuroria në bazë të disa arsyeve, kryesisht mungesë të provave:

1. Nuk konsumohen të gjitha elementet e veprës penale, mungon elementi i dashjes, i përfitimit apo edhe dëmit;
2. Mos deklarimi i saktë i pasurisë nuk është bërë me qëllim të fshehjes së saj;
3. Mos deklarimi i saktë i pasurisë nuk është bërë me dashje direkte por për shkak të mosdijes;
4. Mos deklarimi i saktë i pasurisë ka qenë gabim teknik, jo deklarim i plotë në sipërfaqe të përgjithshme;
5. Parashkrim absolut.

Aspekte rreth trajtimit të rasteve në gjykatë gjatë vitit 2020

Nga informacionet e pranuara gjatë vitit 2020, nga Gjykatat respektive lidhur me rastet e dyshuara për korrupsion sipas aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë kompetente mbi bazën e kallëzimeve penale të AKK-së, janë nxjerr 22 Aktgjykime dënuese dhe 1 aktgjykim lirues. Në mënyrë tabelore këto të dhëna sipas gjykatave duken si në tabelën vijuese.

Tabela 1. Vendimet e gjykatave përkitazi me Nenin 437 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovë përkatësisht 430 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovë

Nr.	Gjykata	Aktgjykim dënues	Aktgjykim lirues
1	GJTH. Prishtinë	9	-
2	GJTH. Prizren	1	-
3	GJTH. Gjilan	2	-
4	GJTH. Gjakovë	8	-
5	GJTH. Mitrovicë	1	1
7	GJTH Ferizaj	1	-
GJITHSEJ:		22	1

Me aktgjykime dënuese Gjykatat kanë shqiptuar kryesisht dënime me kusht (dënime me gjobë dhe burgim), ndërsa ka raste kur janë shqiptuar edhe dënim me burgim efektiv por edhe dënime vetëm me gjobë.

Dënimet me kusht kryesisht janë shqiptuar me dënime me burgim nga 2 muaj deri në 6 muaj me kohë të verifikimit deri në 1 vit. Ka raste kur Gjykata ka shqiptuar dënim me burgim efektiv, në kohëzgjatje prej 120 ditëve deri në 180 ditë e të cilat me marrëveshje në mes Gjykatës dhe të dënuarve janë zëvendësuar me dënim me gjobë në vlerë nga 1,200.00€ deri në 2,000.00€.

Dënimet me gjobë janë shqiptuar në shumë prej 200 euro deri në 800 euro. Tek këto dënime është caktuar që të paguhen kryesisht pas plotfuqishmërisë së aktgjykimeve dhe në disa raste me këste, me mundësinë e revokimit në dënim me burg, ku 20 euro do të llogaritet me një ditë burgimi në rast se i akuzuari nuk e paguan atë dhe e njëjta nuk mund të ekzekutohet me detyrim.

Aktgjykimet dënuese i referohen veprës penale nga neni 437 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovë, përkatësisht 430 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës, ku 12 raste për mos deklarim të pasurisë sipas paragrafit 1 të këtij neni, përkatësisht 8 raste janë për mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë, 3 raste për mos deklarim me marrjen e detyrës, 1 rast për mos deklarim pas mbarimit nga funksioni dhe 10 raste për deklarim të rremë të pasurisë apo mos paraqitje të të dhënave të kërkuara në deklaratë sipas paragrafit 2 të këtij neni, përkatësisht 2 për mos paraqitje të saktë të të hyrave vjetore, 3 për mos paraqitje të biznesit (zotërimit të aksioneve në shoqëri tregtare), 2 për mos paraqitje të saktë të pasurisë së luajtshme (veturë) dhe 3 për mos paraqitje të saktë të pasurisë së paluajtshme.

Me aktgjykim lirues, 1 rast Gjykata ka liruar nga akuza të akuzuarin për mos deklarim të pasurisë, përkatësisht për mos paraqitje të saktë të pasurisë së paluajtshme.

Gjatë vitit 2020 Gjykata e Apelit kishte vendosur në 2 raste e që i referohen nenit 437 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovë përkatësisht nenit 430 paragrafi 1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovë për mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë, 1 rast kishte vërtetuar Aktgjykimin dënues të Gjykatës Themelore në Prishtinë marr nga kjo e fundit gjatë vitit 2019 dhe në 1 rast e kishte ndryshuar Aktgjykimin e marr nga Gjykata Themelore në Prishtinë gjatë këtij vitit raportues, sa i përket sanksionit penal ashtu që dënimin me gjobë të shqiptuar në vlerë prej 300€ i kishte shtuar edhe dënimin me kusht me 2 muaj burgim e i cili nuk të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit duke filluar në afat prej 1 viti.

Rastet e mbyllura

Gjatë kësaj periudhe raportuese AKK pas zhvillimit të procedurave hetimore paraprake ka mbyllur **112** raste. Arsyet për mbylljen e tyre janë si vijon:

- ⇒ **94** raste janë mbyllur për shkak se pas zhvillimit të procedurës së hetimeve paraprake është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të bazuar se rasti mund të përbëjë vepër penale apo shkelje administrative;
- ⇒ **4** raste janë mbyllur në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, për shkak se Agjencia nuk ka pas kompetencën për zhvillimin e procedurës së hetimeve paraprake; dhe

⇒ **14** raste janë mbyllur për shkak se ka qenë duke u zhvilluar procedurë penale nga organet kompetente, ku prej tyre: 6 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, 3 raste nga Prokuroria Themelore në Gjilan, 1 nga Prokuroria Themelore në Pejë, 1 rast nga Prokuroria Themelore në Prizren, 1 nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, 1 nga Prokuroria e Shtetit dhe 1 rast nga DHKEK-Policia e Kosovës.

Zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve

Ligji nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (LMS), i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019, si detyrë për AKK ka paraparë pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit të jashtëm në sektorin publik, inicimin e kërkesave për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër punëdhënësve dhe zyrtarëve përgjegjës të cilët nuk i përmbushin obligimet sipas këtij ligji, pranimin dhe evidentimin i raporteve nga institucionet publike, subjektet private, si dhe rregullatorët lidhur me sinjalizimin.

Me qëllim të zbatimit të dispozitave të këtij ligji, AKK gjatë vitit 2020 ka zhvilluar këto aktivitete:

- Me datat 10 dhe 11 shkurt 2020, kemi pasur takim me ekspertin e Këshillit të Evropës për aspektet praktike të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, rasteve praktike, në Agjenci, si dhe diskutime rreth draft rregullores për hartimin e Rregullores për Pranimin dhe Trajtimin rasteve të Sinjalizimit.
- Me datat 12-13 shkurt, 12 mars, 30 korrik, 28 shtator, 19 tetor, 21 tetor, 27 tetor dhe 02 nëntor, kemi pasur takim me grupin punues, për hartimin e Rregullores për Pranimin dhe Trajtimin rasteve të Sinjalizimit.
- Me datë 8 janar 2021, zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në institucionet publike iu kemi drejtuar me email, që në kuptim të nenit 29 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, si Institucion Publik të përgatisin Raportin Vjetor lidhur me sinjalizimin për vitin paraprak deri më 31 dhjetor dhe të njëjtin ta paraqesin në Agjencinë kundër Korrupsionit më së voni deri me 31 janar të vitit vijues.

Raport lidhur me Kërkesat për fillimin e procedurës së kundërvajtjes dhe rastet e sinjalizimit të jashtëm, për vitin 2020

Gjatë vitit 2020, AKK ka paraqitur 23 Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Kundërvajtje, ndaj institucioneve publike të cilat nuk kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim brenda afatit të paraparë ligjor sipas LMS. Gjatë vitit 2020, Agjencia ka pranuar 5 informacione për sinjalizim të jashtëm, të cilat janë trajtuar brenda afateve të parapara ligjore:

Rasti I

Informata është refuzuar me arsyetimin se:

- në pretendimin se si sinjalizues i brendshëm nuk është informuar për rezultatin e procedurës, AKK ka vërtetuar se për njërin informacion të sinjalizuar i njëjti është

njoftuar, ndërsa për informacionin tjetër nuk është njoftuar lidhur me rezultatin, për arsye se është në procedurë të hetimit administrativ.

- në pretendimin se masat e ndërmarra ndaj tij kanë të bëjnë me sinjlizimit e brendshme, AKK nuk ka arritur deri në një përfundim se ato janë ndërmarrë për shkak të sinjalizimeve të tij.
- lidhur me përmbajtjen e informacionit të sinjalizimit të brendshëm, të njëjtat sinjalizuesi i ka paraqitur në AKK, si informatë për keqpërdorim të detyrës zyrtare, rast i cili është trajtuar në AKK, brenda afateve ligjore dhe kompetencave të AKK në procedurë të hetimeve paraprake.

Rasti i II, IV dhe V

Janë refuzuar me arsyetimin se informatat, bazuar në dispozitën e nenit 16 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, fillimisht duhet të trajtohen brenda institucionit, përmes sinjalizimit të brendshëm, ose drejtpërdrejtë në AKK, në situatat e parapara në dispozitat e nenit 18 të këtij ligji.

Rasti-III

Rasti është mbyll sepse informacioni nuk i përmbush kërkesat të cilat duhet ti përmbajë një sinjalizim sipas nenit 14 paragrafi 2, 15 paragrafi 1 dhe 18 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Dokumentacioni nuk përmban të dhënat e personit që sinjalizon dhe personit kundër të cilit paraqitet sinjalizimi, kurrfarë pretendimi ose informate të kuptueshme, ashtu siç është përcaktuar me nenin 14 paragrafi 2 të këtij ligji.

Raportet nga institucionet publike, subjektet private, si dhe rregullatorët lidhur me sinjalizimin

Sa i përket raporteve nga institucionet publike, subjektet private, si dhe rregullatorët lidhur me sinjalizimin, kemi pranuar këto raporte nga këto institucione:

Tabela 2. Pranimi i raporteve nga institucionet publike lidhur me sinjalizimin

Nr.	Institucioni	Numri i raportimeve dhe shpalosjeve në interes publik	Veprimet e ndërmarra lidhur me rastin
1.	Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës	Asnjë rast	
2.	Agjencia për Barazi Gjinore	Asnjë rast	
3.	Sekretariati i Këshillit të Sigurisë i Kosovës	Asnjë rast	
4.	Agjencia e Statistikave të Kosovës	Asnjë rast	
5.	Instituti i Kosovës për Administratë Publike	Asnjë rast	
6.	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Asnjë rast	
7.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Asnjë rast për periudhën 18.09.2020 deri me 31.12.2020.	
8.	Instituti Pedagogjik i Kosovës	Asnjë rast	
9.	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e te Rriturve	Asnjë rast	
10.	Instituti Albanologjik i Prishtinës	Asnjë rast	

11.	Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren	Dy raste	Rasti i është mbyllur në mungesë të provave; Rasti II është në procedurë të hetimeve
12.	Universiteti "Kadi Zeka" Gjilan	Asnjë rast	
13.	Universiteti "Fehmi Agani" Gjakovë	Asnjë rast	
14.	Universiteti i Shkencave te Aplikuara Ferizaj	Asnjë rast	
15.	Qendra e Studentëve	Asnjë rast	
16.	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Asnjë rast	
17.	Agjencia Pyjore e Kosovës	Asnjë rast	
18.	Ministria e Drejtësisë	Asnjë rast	
19.	Agjencia për Administrimin e Pasurisë se Sekuestruar ose te Konfiskuar	Asnjë rast	
20.	Shërbimi Korrektues i Kosovës	Asnjë rast	
21.	Shërbimi Sprovës i Kosovës	Asnjë rast	
22.	Administrata Tatimore e Kosovës	Asnjë rast	
23.	Dogana e Kosovës	Asnjë rast	
24.	Njësia e Inteligjencës Financiare	Asnjë rast	
25.	Agjencia Qendrore e Prokurimit	Asnjë rast	
26.	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	Asnjë rast	
27.	Ministria e Mbrojtjes	Asnjë rast	
28.	Ministria për Komunitete dhe Kthim	Asnjë rast	
29.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Një rast	Pas zhvillimit të hetimeve administrative është hartuar raporti i cili është përcjellë për veprime të mëtutjeshme Sekretarit të MKRS
30.	Teatri Kombëtar i Kosovës	Asnjë rast	
31.	Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve – Shota	Asnjë rast	
32.	Agjencioni Kadastral i Kosovës	Asnjë rast	
33.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	Asnjë rast	
34.	Inspektorati i Punës	Asnjë rast	
35.	Ministria e Punëve të Brendshme	Një rast	Është dorëzuar me raport te punëdhënësi me rekomandimet që duhet të zbatohen
36.	Policia e Kosovës	Asnjë rast	
37.	Inspektorati Policor i Kosovës	Asnjë rast	
38.	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	Asnjë rast	
39.	Ministria e Zhvillimit Rajonal	Asnjë rast	
40.	Ministria e Shëndetësisë	Asnjë rast	
41.	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar	136 raste	Nuk kemi informacione sqaruese lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e SHSKUK, lidhur me këto raste, edhe pse i është kërkuar sqarim.
42.	Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës	Asnjë rast	
43.	Agjencia për Produkte dhe Pajisje Mjekësorë	Një rast	Rasti është në procedurë të hetimeve
44.	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike	Asnjë rast	

45.	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike	Asnjë rast	
46.	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë	Asnjë rast	
47.	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	Asnjë rast	
48.	Agjencia për Menaxhimin e Kompleksev Memoriale të Kosovës	Asnjë rast	
49.	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	Asnjë rast	
50.	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	Asnjë rast	
51.	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	Asnjë rast	
52.	Agjencia Kosovare e Privatizimit	Asnjë rast	
53.	Autoriteti i Aviacionit Civil	Asnjë rast	
54.	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës	Asnjë rast	
55.	Agjencia për Shoqërinë e Informacionit	Asnjë rast	
56.	Instituti i Mjekësisë Ligjore	Asnjë rast	
57.	Agjencia për Shërbimin e Navigacionit Ajror	Asnjë rast	
58.	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	Asnjë rast	
59.	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës	Asnjë rast	
60.	Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës	Asnjë rast	
61.	Agjencia kundër Korrupsionit	Asnjë rast	
62.	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	Asnjë rast	
63.	Zyra Kombëtare e Auditimit	Asnjë rast	
64.	Organi Shqyrtues i Prokurimit	Asnjë rast	
65.	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	Asnjë rast	
66.	Komisioni i Pavarur i Mediave	Asnjë rast	
67.	Akademia e Drejtësisë	Asnjë rast	
68.	Institucioni Avokatit i Popullit	Asnjë rast	
69.	Banka Qendrore e Kosovës	Asnjë rast	
70.	Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	Asnjë rast	
71.	Zyra e Rregullatorit për Energji	Asnjë rast	
72.	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	Asnjë rast	
73.	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	Asnjë rast	
74.	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës	Asnjë rast	
75.	Agjencia për Informim dhe Privatësi	Asnjë rast	
76.	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	Asnjë rast	
77.	Radio Televizioni i Kosovës	Asnjë rast	
78.	Komuna e Dragashit	Asnjë rast	
79.	Komuna e Gjakovës	Një rast	Është përfunduar rasti, është njoftuar organi kompetent
80.	Komuna e Gjilanit	Asnjë rast	
81.	Komuna e Istogut	Asnjë rast	
82.	Komuna e Junikut	Asnjë rast	
83.	Komuna e Kamenicës - Dardanës	Asnjë rast	
84.	Komuna e Klinës	Asnjë rast	
85.	Komuna e Leposaviqit	Asnjë rast	
86.	Komuna e Mamushës	Asnjë rast	
87.	Komuna e Mitrovicës	Asnjë rast	
88.	Komuna e Novobërdës - Artanës	Asnjë rast	
89.	Komuna e Obiliqit	Asnjë rast	
90.	Komuna e Pejës	Asnjë rast	
91.	Komuna e Podujevës	Asnjë rast	

92.	Komuna e Prizrenit	Asnjë rast	
93.	Komuna e Rahovecit	Asnjë rast	
94.	Komuna e Shtërpcës	Asnjë rast (Fillimisht ka raportuar si zyrtar përgjegjës për rastet kundër diskriminimit, ndërsa përmes telefonit ka konfirmuar se as si zyrtar përgjegjës për sinjalizim nuk ka pranuar asnjë rast).	
95.	Komuna Shtime	Asnjë rast	
96.	Komuna Skenderaj	Asnjë rast	
97.	Komuna e Suharekës	Asnjë rast	
98.	Komuna e Zveçanit	Asnjë rast	
99.	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës	Asnjë rast	
100.	Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut	Një rast	Rasti është përcjellë tek punëdhënësi dhe AKK
101.	Telekomunikacioni i Kosovës-Vala	Asnjë rast	
102.	NP Trainkos SHA	Asnjë rast	
103.	Kompania për Menaxhimin e Deponive	Një rast	Është paraqitur Fletëparaqitje për Shkelje Disiplinore
104.	Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë	Asnjë rast	
105.	Kompania e Ujitjes Radoniqi –Dukagjini-Gjakovë	Asnjë rast	
106.	Kompania Rajonale e Ujësjellësit-Prishtina	Asnjë rast	
107.	Kompania Rajonale e Ujësjellësit Mitrovica	Asnjë rast	
108.	KRU Hidromorava -Gjilan	Asnjë rast	
109.	Kompania Rajonale e Ujësjellësit Radoniqi Gjakovë	Asnjë rast	
110.	Ngrohtorja e Qytetit Termokos-Prishtinë	Asnjë rast	
111.	Ndërmarrja Publike Banesore-Prishtinë	Asnjë rast	
112.	Kompania e Rajonale e Mbeturinave-Pastrimi, Prishtinë	Asnjë rast	
113.	Kompania Rajonale e Mbeturinave-Eko-Regjion, Prizren	Asnjë rast	
114.	Kompania Rajonale e Mbeturinave-Uniteti-Mitrovicë	Asnjë rast	
115.	Ndërmarrja Publike Hortikultura – Prishtinë	Asnjë rast	
116.	Ndërmarrja Publike-Stacioni i Autobusëve Pejë	Asnjë rast	
117.	Ndërmarrja Publike-Stacioni i Autobusëve Gjilan	Asnjë rast	
118.	Ndërmarrja Publike-Stacioni i Autobusëve Gjakovë	Asnjë rast	
119.	Ndërmarrja Publike-Stacioni i Autobusëve Ferizaj	Asnjë rast	
120.	Ndërmarrja Publike-Stacioni i Autobusëve Mitrovicë	Asnjë rast	
121.	Ndërmarrja Publike-Stacioni i Autobusëve Prizren	Asnjë rast	
122.	Ndërmarrja Publike Pallati i Rinise Prishtinë	Asnjë rast	
123.	Ndërmarrja Publike Trafiku Urban Prishtinë	Asnjë rast	
124.	Gjykata Themelore në Gjakovë	Asnjë rast	

Raport nga institucionet të cilat me ndryshimet e fundit në Qeverinë e Republikës së Kosovës, së zgjedhur me vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, datë 03.06.2020, dhe bazuar në Rregulloren (QRK)-Nr.06/2020 për fushat e përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, sipas së cilës Qeveria e Republikës së Kosovës përbëhet nga 16 ministri, janë riorganizuar në kuadër të ministrive caktuara:

Tabela 3. Pranimi i raporteve për sinjalizim nga institucionet pas bashkimit të disa ministrive

125.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Dy raste	Rasti I është përfunduar brenda afatit ligjor dhe janë kryer të gjitha veprimet sipas legjislacionit. Rasti II, pas realizimit të hetimit administrativ, është vënë në dijeni organi kompetent
126.	Ministria e Integrimeve Evropiane	Asnjë rast	
127.	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	Asnjë rast	
128.	Ministria e Administratës Publike	Asnjë rast	

Tabela 4. Raport nga subjektet private

129.	Turkiye Is Bankasi A.S. Dega në Kosovë	Asnjë rast	

Strategjia dhe Plani i Veprimit

Agjencia kundër Korrupsion (në tekstin e mëtejmë AKK) në muajin prill të viti 2020 ka filluar përgatitjet për hartimin e Strategjisë dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsion 2021-2023, ndërsa në muajin qershor të viti 2020 ka filluar punën me Grupin Punues. Grupi punues përbëhet nga institucionet që janë përgjegjëse për parandalimin/luftimin e korrupsionit dhe sundimin e ligjit në Kosovë, po ashtu i njëjti grup punues ka përfshirë edhe përfaqësues të shoqërisë civile. Institucionet e angazhuara në këtë Grup Punues janë nga: AKK, KGJK, KPK,MPB, KUVENDI, MPL, PK, IPK, ZKM, KRPP, OSHP, MF, KQZ, MTI, MD, MSH, MASH, nga shoqëria civile ka qenë e angazhuar OJQ "Lëvizja FOL". AKK ka mbajtur disa takimet sektoriale, me përfaqësues nga Sektori Politik, Administrata Publike (Administrata Shtetërore dhe Qeverisja Lokale), institucionet e zbatimit të Ligjit /Gjyqësori dhe Prokurimi Publik/Menaxhimi i Financave Publike, takime me pikat e kontaktit, takime me anëtarët e grupit punues si dhe takime me përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Në qershor të vitit 2020, AKK ka përcjellë te pikat e kontaktit materialin për diskutim dhe në muajin gusht të vitit 2020 kemi përcjell një kërkesë që të njëjtit të japin komentet e tyre në lidhje me masat/aktivitetet që janë të përfshira në draft Planin kundër Korrupsion 2021-2023, të propozojnë aktivitete tjera të reja dhe të japin mendimin e tyre se cilat aktivitet janë ende të rëndësishme për sektorin të cilin e përfaqësojnë. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, Drejtori i Agjencisë ka mbajtur takime për çështjen e strategjisë me përfaqësuesit e institucioneve vendore dhe organizatave ndërkombëtare që përkrahin hartimin e kësaj strategjie, si me Kryetarin e

Kuvendit të Kosovës, Zv. Kryeministrin e Qeverisë së Kosovës, Ministria e Drejtësisë, përfaqësuesit nga UNDP, Projekti SAEK II, Zyra e BE-së, Projekti PECK III, si dhe nga ODPAT nga Ambasada Amerikane.

Anëtarët e grupit punues kanë dhënë komentet e tyre dhe propozimet në lidhje me masat dhe aktivitete e planit të veprimit. Komentet e tyre janë pranuar dhe diskutuar në takimet e mëvonshme të grupit punues. AKK nga data 01.09.2020 deri 04.09.2020 ka organizuar katër takime me sektorët e veçantë të Strategjisë si: 1. Sektorin Politik Publik, 2. Sektorin e Administratë Publike (Administrata Shtetërore dhe Qeverisja Lokale), 3. Sektorin për institucionet e zbatimit të Ligjit/Gjyqësori dhe 4. Sektorin për Prokurimin Publik/Menaxhimin e Financave Publike.

Pas këtyre takimeve me datë 15.09.2020 është përcjell Planin e Veprimit kundër Korrupsion 2021-2023 i përditësuar me qëllim komenteve eventuale finale nga këto subjekte të përfshira.

AKK me datë 17.11.2020 ka kërkuar opinion nga Departamenti i Buxhetit të Ministrisë së Financave për vlerësimin e ndikimit financiar për Strategjinë kundër Korrupsionit 2021-2023, dhe me datë 08.12.2020 kemi marrë opinionin pozitiv nga Ministria e Financave për procedim të mëtutjeshëm.

Me datë 11.12.2020 kemi përcjell në Qeverinë e Kosovës Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsion 2021-2023 për aprovim. Dhe më datë 21.12.2020 është aprovuar nga Qeveria e Kosovës Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Korrupsion 2021-2023 dhe e njëjta është proceduar sipas këtij vendimi në Kuvendin e Republikës së Kosovës për procedimi të mëtutjeshëm. Sidoqoftë, edhe ky draft i Strategjisë nuk është miratuar për shkak të shpërndarjes së Kuvendit dhe shpalljes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

DEPARTAMENTI PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë, si dhe Ligjin nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit, fushë-veprimtarinë e kryen përmes: (1) mbikëqyrjes së deklarimit të pasurisë, (2) mbikëqyrjes së dhuratave, (3) parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik, dhe (4) parandalimin e korrupsionit në përgjithësi.

AKK mbikëqyrë pasurinë e zyrtarit të lartë publik në bazë të informacionit të dorëzuar nga zyrtarët e lartë publik në formular të posaçëm, i cili është përgatitur nga AKK në pajtim me ligjin në fuqi. Formularët duhet të plotësohen nga zyrtarët e lartë publik dhe të dorëzohen në AKK.

Deklarimi i pasurisë, kontrolli i pasurisë dhe deklarimi i dhuratave

Baza ligjore në të cilën AKK e mbështet punën e vet për mbikëqyrjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë është e definuar në Ligjin nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë, si dhe Ligjin nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë.

AKK mbikëqyrë pasurinë e zyrtarit të lartë publik në bazë të informacionit të dorëzuar nga zyrtarët e lartë publik në formular të posaçëm, i cili është përgatitur nga AKK në pajtim me ligjin në fuqi. Formularët duhet të plotësohen nga zyrtarët e lartë publik dhe të dorëzohen në AKK.

Llojet e deklarimit të pasurisë

Ligji Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë dhe Ligji Nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050 përcakton këto lloje të deklarimeve:

- Deklarimi i rregullt vjetor;
- Deklarimi me marrjen e detyrës;
- Deklarimi sipas kërkesës së Agjencisë;
- Deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni.

Deklarimi i rregullt vjetor – Zyrtarët e lartë publik kanë për obligim deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë gjatë tërë kohës së punës në shërbimin publik dhe në afate të përcaktuara me ligj. Zyrtarët e lartë publik detyrohen të deklarojnë gjendjen e pasurive të tyre në AKK, nga 1 deri më 31 mars të çdo viti për vitin paraprak nga 1 janar deri më 31 dhjetor. Për këtë periudhë kohore ose deklarimin e rregullt vjetor për vitin 2020 kanë pasur për obligim që ta bëjnë deklarimin e

pasurisë së tyre 4721 zyrtar të lartë publik. Prej këtij numri të përgjithshëm e kanë deklaruar pasurinë 4625, ose 98 %, pasurinë nuk e kanë deklaruar 96 zyrtar të lartë publik (63 kanë deklaruar pasurinë pas afatit; 27 nuk kanë deklaruar pasurinë; 6 nuk kanë deklaruar pasurinë me arsye) apo 2 %.

Duke e pasur parasysh situatën e krijuar me pandeminë COVID-19 gjatë vitit 2020, kemi pasur vështirësi në përfundimin e procesit të deklarimit të pasurisë, po ashtu kemi qenë të obliguar që ta shtyjmë edhe afatin e dorëzimit të formularëve për deklarim të pasurisë, afati i fundit i dorëzimit të deklarimit të pasurisë është caktuat 19 qershori. Kryesisht gjatë kësaj periudhe kemi pranuar deklarimin e pasurisë vetëm përmes e-mail dhe jo fizikisht, për shkak të masave të përcaktuara nga Qeveria e Kosovës me qëllim të ruajtjes së shëndetit dhe mbrojtjes nga infektimi me COVID-19.

Nga 96 zyrtar të lartë publik që nuk e kanë respektuar afatin e deklarimit të pasurisë, 45 zyrtar të lartë publik kanë sjell arsyetime të ndryshme për vonesat e deklarimit të pasurisë, ndërsa 51 raste i kemi proceduar në Departamentin për Luftimin e Korrupsionit për trajtim të mëtejmë.

Për periudhën raportuese gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela 5. Deklarimi i rregullt vjetor

Institucionet	Numri i zyrtarëve	Të deklaruar		Nuk kanë deklaruar			
		Deklarimet	Përqindjet	Kanë deklaruar pas afatit	Nuk kanë deklaruar pasurinë	Mos deklarimi me arsye	Përqindjet
Presidenca	25	25	100 %	/	/	/	0 %
Kuvendi	147	147	100 %	/	/	/	0 %
Qeveria	1385	1354	97.8 %	17	11	3	2.2 %
Gjykatat	445	441	99.1 %	4	/	/	0.9 %
Prokurorit	204	204	100 %	/	/	/	0 %
Institucionet e Pavarura	461	460	99.8 %	1	/	/	0.2 %
Komunat e Kosovës	1637	1593	97.3	32	10	2	2.7 %
Ndërmarrjet Publike	417	401	96.2 %	9	6	1	3.8 %
TOTALI	4721	4625	98 %	63	27	6	2 %

Deklarimi me marrjen e detyrës së zyrtarëve të lartë publik - Zyrtarët e lartë publik të cilët fillojnë punën në shërbimin publik në mënyrë të plotë dhe reale deklarojnë me shkrim pasurinë e tyre brenda afatit ligjor. Zyrtari kontaktues është i detyruar që brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor ta njoftoj AKK për fillimin apo përfundimin e punës së zyrtarit të lartë publik, ndërsa zyrtari i lartë publik ka për obligim deklarimin e pasurisë brenda periudhës 30 ditësh nga dita e marrjes së detyrës.

Gjatë vitit raportues kemi pranuar informacione nga zyrtarët kontaktues se kanë filluar ushtrimin e funksionit publik 608, të obliguar të deklarojnë pasurinë me rastin e marrjes së detyrës.

Deklarimi i pasurisë pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni - Pas përfundimit të punës në pozitën e lartë publike, zyrtarët e lartë publik kanë për obligim deklarimin e pasurisë brenda afatit tredhjet (30) ditor.

Gjatë vitit raportues kemi pranuar informacione nga zyrtarët kontaktues se kanë përfunduar ushtrimin e funksionit publik 364, të obliguar të deklarojnë pasurinë pas largimit nga funksioni publik.

Bazuar në të dhënat e raportuara gjatë vitit 2020, për të gjitha llojet e deklarimit kanë qenë të obliguar ta bëjnë deklarimin 5693 zyrtar të lartë publik.

Pasqyrimi i deklarimit vjetor për të gjitha llojet e deklarimit të pasurisë:

Tabela 6. Deklarimi i pasurisë 2020

Lloji i deklarimit	Të obliguar
Deklarimi i rregullt vjetor	4721
Me marrjen e detyrës	608
Sipas kërkesës	-
Pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni	364
Numri i përgjithshëm	5693

Lista e Zyrtarëve që nuk kanë deklaruar pasurinë në afatin ligjor është pasqyruar në *Shtojcën_2*; Lista e Zyrtarëve që kanë deklaruar pasurinë pas afatit ligjor është pasqyruar në *Shtojcën_3*. Lista e Zyrtarëve që nuk kanë deklaruar pasurinë në afat ligjor për arsye shëndetësore dhe të tjera është pasqyruar në *Shtojcën_4*.

Kontrolli i deklarimit të pasurisë

Bazuar në mandatin që ka, AKK ka zhvilluar kontrollin paraprak dhe kontrollin e plotë të formularëve për deklarim të pasurisë të paraqitur nga zyrtarët e lartë publik.

Kontrolli paraprak - Kontrolli paraprak kryhet për çdo formular për të verifikuar ekzistimin/ apo mos ekzistimin e gabimeve materiale ose plotësimeve të gabuara të formularit. Gjatë regjistrimit te të dhënave në data bazë kemi bërë edhe kontrollin paraprak, ku kemi vërejtur shumë gabime në plotësimin e formularëve për deklarim të pasurisë, gabime më të theksuara i kemi vërejtur tek zyrtarët e lartë publik që kanë deklaruar pasurinë për herë të parë, si dhe tek zyrtaret e institucioneve të niveleve lokale.

Në rastet kur kemi vërejtur gabime të vogla apo gabime të cilat kemi pasur mundësi përmirësimi përmes kontaktit telefonik, në i kemi kontaktuar dhe i kemi evituar ato gabime teknike. Në rastet më të theksuara ju kemi drejtuar me shkresa zyrtare. Në 547 raste kemi vërejtur gabime teknike tek formularët për deklarim të pasurisë së paraqitur, të cilëve kemi kërkuar përmirësim apo plotësimin e të dhënave sipas kërkesave të formularit dhe legjislacionit në fuqi.

Kontrolli i plotë - Kontrolli i plotë kryhet për ta verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara në formular. AKK ka obligim ligjor për të zhvilluar kontrollin e plotë për zyrtarët e lartë publikë të cilët deklarojnë pasurinë. Gjatë periudhës raportuese AKK ka bërë kontrollin e plotë për 20% nga numri i përgjithshëm i deklarimeve në bazë të shortit të organizuar i cili parashihet me ligjin për deklarim të pasurisë. Po ashtu kemi trajtuar të gjitha informacionet që kemi pasur sa i përket deklarimit të pasurisë.

AKK ka bërë krahasimin e të dhënave të deklaruara ndër vite, krahasimin e të dhënave të pranuara nga institucionet tjera si: Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Ministria e Financave, Ndërmarrjet Publike, Agjencia e Regjistrimit të Civil, Administrata Tatimore e Kosovës, Universitetet Private, Njësia e Inteligjencës Financiare, Dogana etj.

Nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë publik që kanë për obligim deklarimin e pasurisë janë kontrolluar 950 zyrtar të lartë publik sipas listë së shortit.

Agjencia i ka trajtuar edhe 18 raste ex-officio apo sipas informatave të raportuara nga qytetarët përmes formave të ndryshme.

Tabela e mëposhtme pasqyron procesin e kontrollit të plotë.

Tabela 7. Kontrolli i plotë i deklarimit të pasurisë si dhe rezultatet e gjetjeve nga kontrolli i plotë

Sipas listës së shortit	Ex-officio	Gjithsej në kontroll	Të përfunduara	Në procedurë	Të përcjella në DLK-AKK/ Prokurori/Polici	
					Mos deklarim te pasurisë	Dyshimet për deklarim te rrem
950	18	968	307	661	51	26

Katalogu i dhuratave

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-050 si dhe Ligjin Nr. 04/L-228, Institucionet publike duhet t'i emërojnë zyrtarët përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të dhuratave. Të gjitha dhuratat e pranuara dhe vlera e tyre përkatëse, si dhe emrat e personave që kanë dhënë dhuratën, duhet të regjistrohen në regjistrin e dhuratave nga personi zyrtar që përcaktohet nga Agjencia dhe që mbahen nga institucioni, në të cilin personi zyrtar ushtron detyrën. Kopjet e katalogëve duhet t'i dërgojnë në AKK jo më vonë se më 31 mars të vitit në vijim.

Dorëzimi i katalogut të dhuratave

Agjencia kundër Korrupsionit, gjatë muajit mars të vitit 2020 ka pranuar njoftimin nga 15 institucione, 4 prej tyre kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata, ndërsa 11 kanë deklaruar se nuk kanë pranuar dhurata gjatë vitit paraprak.

Institucionet të cilat kanë dorëzuar kopjet e katalogut të dhuratave gjatë këtij viti për vitin paraprak janë: Kuvendi i Kosovës 1 dhuratë; Zyra e Kryeministrit 24 dhurata; Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren 8 dhurata; Kuvendi Komunal Rahovec 1 dhuratë.

Të dhënat e specifikuara lidhur me katalogët e dhuratave sipas institucioneve që i kanë dorëzuar kopjet e katalogut në AKK, janë të paraqitura në tabelën në vijim.

Tabela 8. Raporti i dhuratave të deklaruara nëpër institucione

Institucioni	Dhurata protokollare	Dhurata të rastit	Numri i përgjithshëm
Kuvendi i Kosovës	0	1	1
Zyra e Kryeministrit	23	1	24
Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren	8	0	8
Kuvendi Komunal Rahovec	1	0	1
Totali	32	2	34

Parandalimi i korrupsionit në prokurimin publik

Aktivitetet e parandalimit të korrupsionit në fushën e prokurimit publik nga ana e AKK i zhvillon Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik. Ky divizion si prioritet kryesor të objektivit të përgjithshëm ka pasur parandalimin e korrupsionit. Për përmbushjen e këtij objektivi, zyrtarëve të këtij divizioni iu janë caktuar katër detyra kryesore: (1) Parandalimi i shkeljeve ligjore me elemente korruptive ne aktivitet e prokurimit (2) Përmirësimi i aktiviteteve të prokurimit përmes ofrimit të opinioneve (3) Monitorimi i aktiviteteve prokurimit (4) Identifikimi i konfliktit te interesit në aktivitete të prokurimit në lidhje me komisionet vlerësuese dhe mbikëqyrëse gjate procesit të monitorimit dhe për përmbushjen e këtyre detyrave janë caktuara edhe aktivitetet konkrete.

Sipas legjislacionit në fuqi AKK zhvillon procedurën e caktuar me iniciativën e saj sipas detyrës zyrtare. AKK përcjellë publikimin e aktiviteteve të prokurimit në ëeb faqen zyrtare të KRPP-së nga autoritetet kontraktuese, aktivitetet me vlerë të vogël të mëdha dhe të mesme. AKK po ashtu ka përcjellë publikimet në media të cilat i ka konsideruar si burime informacioni për shkeljet e mundshme ligjore në aktivitetet e caktuara të prokurimit publik.

Një formë tjetër e parandalimit të shkeljeve ligjore me elemente korruptive është edhe pjesëmarrja në cilësinë e vëzhguesit në te gjitha fazat e aktiviteteve të prokurimit sipas nenit 21 paragrafit 3 te Ligjit Nr.061/L-011.

Pas trajtimit të dokumentacionit dhe fakteve tjera të mbledhura, në rast se janë evidentuar shkelje ligjore, AKK i ka ofruar Autoritetit Kontraktues opinion parandalues. Ndërsa, sa i përket rasteve kur nuk vërehet se është evidentuar ndonjë shkelje ligjore me elemente korruptive dhe kur aktiviteti i prokurimit ndërpritet nga Autoriteti Kontraktues konform ligjit, AKK vendos për mbylljen e rastit të përcjellë me raport përfundimtar.

Nëse gjatë trajtimit të rastit Agjencia vëren se rasti i njëjtë është objekt trajtimi në ndonjë organ tjetër, atëherë pezullohet trajtimi deri në vendimin përfundimtar të organit kompetent që është duke trajtuar rastin. Nëse Agjencia nuk pajtohet me vendimin përfundimtar të organit në fjalë mund ta përcjellë gjithë dokumentacionin në organet kompetente.

Rastet e protokolluara - informacionet

Agjencia gjatë vitit 2020 ka protokolluar 80 raste për trajtim lidhur me aktivitetet e prokurimit publik, të cilat me vendim janë iniciuar nën dyshimin e arsyeshëm për shkelje ligjore.

Rastet e monitoruara - informacionet

Në përmbushje të obligimit ligjor lidhur me monitorimin e aktiviteteve të prokurimit AKK ne 7 raste ka bërë njoftim zyrtar për monitorim. Vlen të theksohet se të gjitha autoritetet e kanë informuar AKK-në për kohën dhe vendin e saktë të fillimit të procesit të vlerësimit. Andaj AKK ka marrë pjesë në cilësinë e monitoruesit gjatë zhvillimit të procedurave të disa tenderëve ku të gjitha rastet janë mbyllur me raporte pune pa shkelje.

Në Divizionin për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurim Publik gjatë vitit raportues janë trajtuar gjithsej 80 lëndë në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik. Nga këto raste kemi rezultuar me 54 opinione nga te cilat 52 janë respektuar, ndërsa 2 opinione nuk janë respektuar dhe do te procedohet për me tutje, raste të mbyllura 21.

Tabela në vijim pasqyron saktë rastet të cilat Agjencia i ka trajtuar gjatë vitit 2020 në fushën e parandalimit të korrupsionit në Prokurimin Publik:

Tabela 9. Rastet e trajtuara gjatë vitit 2020 në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik

Numri i rasteve	Opinione	Raste të mbyllura me raport	Në procedure	Hetim
80	54	21	4	1

DEPARTAMENIT I PARANDALIMIT TË KONFLIKTIT TË INTERESIT

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Ligjit Nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, Departamenti për Parandalimin e Konfliktit të Interesit fushë-veprimtarinë e kryen përmes: (1) trajtimit të rasteve të konfliktit të interesit; (2) asistencës profesionale për Autoritetet Përgjegjëse dhe nxjerrja e vendimeve, opinioneve, rekomandimeve, këshillave dhe shkresave të tjera në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit, dhe (3) aktivitetet vetëdijësuese.

Ky departament gjatë këtij viti ka qenë i fokusuar kryesisht në parandalimin, zgjidhjen dhe trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit në njërën anë, si dhe në anën tjetër mbështetjen profesionale për Autoritetet përgjegjëse të institucioneve publike të veçanta për parandalimin e konflikti të interesit. Të gjitha këto në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Ligjit Nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Departamenti për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, vitin 2020 e ka nisur me prioritetin që të fuqizoj Autoritetet Përgjegjëse të formuara një vit më parë nëpër institucionet publike të vendit, që për qëllim kanë parandalimin e konfliktit të interesit në burim. Kjo kishte të bënte me vazhdimin e mbajtjes së trajnimeve bazike me ato autoritete të cilat akoma nuk kishin kryer këtë trajnim, si dhe menjëherë me fillimin edhe të nivelit të dytë, më të avancuar, të trajnimit për autoritetet tjera të themeluara më parë. Të gjitha këto në funksion të parandalimit dhe zgjidhjes së rasteve të konfliktit të interesit në burim.

Rrethanat e reja të krijuara me "Covid" gjatë vitit 2020 dhe kërkesa bazike e institucioneve përkatëse shëndetësore për mbajtjen e distancës dhe ndalimin e grupimeve të mëdha, ishte një sfidë shtesë, për të gjetur mundësitë tjera për realizimin e misionit të vet të punës. Në muajit mars-prill, me mbështetjen nga Byroja për çështje ndërkombëtare të narkotikëve dhe zbatimit të ligjit (INL) në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, publikuam dokumentin Udhëzues praktik, për Autoritetet përgjegjëse lidhur me Parandalimin e konfliktit të interesit në institucionet publike. Ky udhëzues përmban përmbledhjen bazë të kornizës ligjore të cilat kanë për qëllim lehtësimin dhe ofrimin e propozimit për hartimin e rregullave për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit brenda institucionit, konform Ligji për parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Udhëzuesi praktik për Autoritetet Përgjegjëse në Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Institucionet Publike ofron udhëzime dhe sqarime për autoritetet përgjegjëse, se si t'i përcaktojnë rregullat, procedurat, detyrat dhe cilat janë përgjegjësitë e tyre karshi obligimeve që dalin nga dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ky dokument është shpërndarë si dosje fizike, por gjithashtu AKK në web faqen e saj ka lënë mundësinë që jo vetëm Autoritetet përgjegjëse, por gjithë të interesuarit ta shkarkojnë si dokument dhe ta kenë në shfrytëzim.

Ky është Botimi i Parë i këtij udhëzuesi i hartuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit me të cilin synohet të mbështeten autoritetet përgjegjëse në punën e tyre, për identifikimin, trajtimin si dhe zgjidhjen e situatave të mundshme të konfliktit të interesit. Prandaj, si i tillë, varësisht nga sfidat

apo problematika e paraqitur nga Autoritetet Përgjegjëse, Agjencia Kundër Korrupsion ka të drejtë të rishikoj, ndryshoj, tërheq apo plotësoj këtë Udhëzues me qëllim të avancimit konform nevojave që mund të paraqiten gjatë procesit të punës. Ky udhëzues mund të shërbej për hartimin e akteve nën-ligjore konform Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në pajtim me udhëzimin administrativ për Standardet e Hartimit të Akteve Normative.

Në pamundësi të organizimit të takimeve në grupe të mëdha si dhe trajnimeve për Autoritetet përgjegjëse, zyrtarët e Agjencisë vazhdimisht kanë mbajtur kontakte, qoftë përmes komunikimit elektorinik (e-mail) qoftë me biseda telefonike, me të gjitha institucionet e vendit, respektivisht Autoritetet Përgjegjëse të tyre, për parandalim të konfliktit të interesit.

Në vijim janë tabelat grafike me përshkrim të detajuar të rasteve të trajtuara nga Departamentit për Parandalimin e konflikti të interesit.

Fillimisht tabela e parë pasqyron numrin e rasteve, sipas institucioneve dhe procedurave, të cilat janë hapur në vitin 2019 e janë trajtuar në vitin 2020.

Tabela 10. Rastet e trajtuar në vitin 2020 nga Divizioni Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për zyrtarë të lartë

Institucioni	Rastet e paraqitura për konflikt të interesit	Raste që janë shmangur nga Konflikti i Interesit	Raste Pa Konflikt Interesi	Raste ende në procedim	Rastet e përcjella për hetim	Kërkesa për kundërvajtje/ për shkarkim	Opinion-Këshilla-Përgjigje
Kuvendi i Kosovës	1	-	1	-	-	-	-
Qeveria dhe Agjencitë	8	1	1	-	-	1	5
Universitetet Publike	2	-	-	-	-	-	2
Gjykata / Prokuroria	4	2	-	-	-	-	2
Institucionet e pavarura	5	2	1	-	2	-	-
Ndërmarrje Publike	6	3	1	-	-	-	2
Pushteti Lokal	7	4	-	-	1	-	2
Gjithsej:	33	12	4	-	3	1	13

Pastaj, tabela në vijim pasqyron numrin e përgjithshëm të rasteve të trajtuara për konflikt interesi nga AKK. Ajo që bie ne sy është fakti se siç shihet janë rritur adresimet me kërkesa për Këshilla dhe Opinione, që në fakt janë mundësia më e mirë për parandalimin e konflikt të interesit në burim, akoma pa ndodhë situata dhe pa prodhuar efekte tjera juridike.

Tabela 11.Numri i përgjithshëm i rasteve të trajtuara për konflikt të interesit

Institucioni	Rastet e paraqitura për konflikt të interesit	Raste që janë shmangur nga Konflikti i Interesit	Raste Pa Konflikt Interesi	Raste ende në procedim	Rastet e përcjella për hetim	Kërkesa për kundërvajtje/ për shkarkim	Opinion-Këshilla-Përgjigje
Kuvendi i Kosovës	2	/	/	/	/	/	2
Qeveria dhe Agjencitë	53	21	10	10	/	1	11
Universitetet Publike	46	26	4	5	/	/	11
Gjykata /Prokuroria	13	8	/	1	1	/	3

Institucionet e pavarura	11	2	2	1	/	/	6
Ndërmarrje Publike	8	1	/	3	/	/	4
Pushteti Lokal	27	12	3	5	1	/	6
Gjithsej:	160	70	19	25	2	1	43

Tabela ne vijim pasqyron numrin e rasteve të konflikti të interesit të trajtuara nga Autoritetet përgjegjëse për vitin 2020.

Tabela 12. Numri i rasteve të trajtuara për konflikt interesi nga autoritetet përgjegjëse

Tabela me rastet e Autoriteteve Përgjegjëse 2020							
Institucioni / Rastet	Gjithsej raste te paraqitura për konflikt të interesit ne AP	Raste që janë shmangur nga Konflikti i Interesit	Raste pa Konflikt Interesi	Raste me Konflikt Interesi/Dërguar në Procedurë Diciplinore	Opinion / Rekomandim	Raste ende në procedurë	Rast i Dërguar në AKK
Qeveria dhe Agjencitë	43	12	6	8	1	3	13
Kuvendi i Kosovës	0	0	0	0	0	0	0
Gjykata / Prokuroria	0	0	0	0	0	0	0
Institucionet e pavarura	5	4	1	0	0	0	0
Ndërmarrje Publike	13	4	2	0	0	0	7
Pushteti Lokal	16	8	0	0	0	0	8
Gjithsej:	77	28	9	8	1	3	28

Gjatë periudhës raportuese AKK ka dhënë përgjigje lidhur me këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, udhëheqësve, institucioneve udhëheqëse, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave.

Tabela 13. Tabela lidhur me këshillimet dhe sqarimet e institucioneve dhe zyrtarëve përmes letërkëmbimeve me komunikim elektronik

Institucioni	Nr. i përgjigjeve
Kuvendi i Kosovës	2
Qeveria	4
Institucionet e Pavarura	4
Ndërmarrje publike	6
Universiteti	4
Policia e Kosovës	1
Media	7
Gjithsej:	28

Gjatë vitit 2020, AKK ka pranuar Vendimet nga dy Gjykata Themelore të vendit të cilat kërkesat e më hershme të AKK-së për gjykim të rasteve të konfliktit. Sipas vendimeve rastet janë mbyllur për shkak të parashkrimit.

Aktivitetet vetëdijësuese të departamentit për parandalimin e konfliktit të interesit

- 21 janar 2020 është organizuar Tryeza me gjyqtarë e prokurorë me temën: "Roli i Agjencisë kundër Korrupsionit në parandalimin e konfliktit të interesit si dhe bashkëpunimi me Autoritetet përgjegjëse".
- Shkurt 2020 del nga shtypi Udhëzuesi Praktik për Autoritetet përgjegjëse lidhur me Parandalimin e konfliktit të interesit në institucionet publike.
- Gjatë javës kundër korrupsionit AKK ka shpërndarë broshura senzibilizuese për shërbyes civil dhe zyrtarë të lartë lidhur me parandalimin e konflikti te interesit.

Po ashtu, bashke me broshura, janë shpërndarë dhe materiale të tjera promovuese me mesazhin "Vendimmarrje pa konflikt interesi" me qëllim të informimit të zyrtarëve publik.

MBËSHTETJA PROFESIONALE DHE BASHKËPUNIMI

AKK, sikurse në vitet paraprake, edhe gjatë vitit 2020 ka vazhduar punën e saj në aspektin e mbështetjes profesionale dhe të bashkëpunimit përmes Zyrës për Mbështetje Profesionale dhe Bashkëpunim, duke bërë koordinimin e aktiviteteve të saj konform situatës me pandeminë COVID-19.

Gjatë vitit 2020, aktivitet kryesore në këtë drejtim ishin të fokusuara në:

1. Mbështetja ligjore dhe përfaqësimi i rasteve në institucionet e drejtësisë;
2. Përfaqësimi i Agjencisë në takime sa i përket politikave kundër korrupsion;
3. Bashkëpunim me institucione vendore dhe ndërkombëtare;
4. Menaxhimi dhe administrimi i teknologjisë informative;
5. Mbështetja profesionale në zhvillimin e platformës për deklarimin online të pasurisë;
6. Arkivimi i dokumenteve dhe shkresave; etj.

AKTIVITETET JURIDIKE

Në kuadër të punëve juridike brenda periudhës kohore 1 janar – 31 dhjetor 2020 janë ofruar këshilla të shumta juridike lidhur me përgjegjësitë e Agjencisë sipas legjislacionit në fuqi. Në këtë kontekst, janë përpiluar vendime të shumta si dhe parashtresa tjera për nevojat e Agjencisë, janë bërë përfaqësime në institucionet e drejtësisë lidhur me rastet e iniciuara nga Agjencia si dhe shumë punë tjera që hyjnë në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të Agjencisë.

Mbështetja profesionale juridike dhe legjislacioni

Gjatë vitit 2020 janë zhvilluar aktivitete të shumta sa i përket zbatimit të legjislacionit. Janë organizuar punëtori, tryeza si dhe takime të ndryshme online me institucione, si dhe grupe të tjera të interesit konform situatës me pandeminë, si dhe mandatin e Agjencisë, në raport me detyrat dhe përgjegjësitë në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë që kanë institucionet me AKK. Në aspekt të zbatimit të legjislacionit të avancuar si të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik si dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve është ofruar asistencë profesionale gjatë hartimit të shkresave të ndryshme, opinioneve, rekomandimeve dhe vendimeve sidomos në fushën e konfliktit të interesit.

Përfaqësimi i rasteve

Gjatë vitit 2020 janë përfaqësuar raste të shumta të iniciuara nga Agjencia në institucionet e drejtësisë, të cilat raste kryesisht janë iniciuar për veprat penale:

- ⇒ "Mos deklarimi ose deklarimit i rrejshëm i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave ose i dobisë tjetër materiale" sipas Nenit 437 të Kodit Penal të Kosovës;
- ⇒ "Konflikt interesi" sipas Nenit 424 të Kodit Penal të Kosovës; si dhe

⇒ "Vepra kundërvajtëse" sipas dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit;

Përfaqësimi është bërë në Gjykatat dhe Prokuroritë kompetente, varësisht se në cilën fazë kanë qenë duke u zhvilluar procedurat për rastet konkrete.

Gjatë vitit 2020, varësisht nga nevojat dhe kërkesat e Agjencisë janë përpiluar parashtresa të shumta juridike (vendime, kërkesa, kontrata, memorandume mirëkuptimi etj.) si dhe janë ofruar opinione apo këshilla ligjore.

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të tjera shtesë, sipas kërkesave gjatë vitit 2020 është ofruar po ashtu ndihmë dhe përkrahje profesionale për të gjitha njësitë organizative brenda institucionit, në analizimin e çështjeve të ndryshme brenda mandatit të institucionit, duke dhënë kontribut në ofrimin e zgjidhjeve sipas legjislacionit në fuqi.

Përfaqësimi i Agjencisë në takime të ndryshme

Duke e marrë parasysh situatën me COVID-19, AKK gjatë vitit 2020 në kuadër të përfaqësimit të saj në takime, ka marrë pjesë në shumë takime me institucione vendore dhe ndërkombëtare, lidhur me politikat kundër korrupsion. Disa prej këtyre takimeve janë organizuar dhe realizuar në grupe të vogla dhe të tjera në formë virtuale për shkak të situatës me pandeminë.

Menaxhimi i Teknologjisë Informative

Sistemi i teknologjisë informative është i menaxhuar dhe administruar nga Administratori i Lartë i TI-së për Sisteme në kuadër të zyrës ZMPB-AKK, ku gjatë vitit 2020 ka vazhduar rrjedhën e avancimit të sistemit të teknologjisë informative, duke i ngritur sistemet operative në versionin e fundit, si dhe programet e aplikacionet e tjera, si dhe ka paraparë dhe kërkuar që të bëhet edhe ndërrimi i serverëve dhe pajisjeve të tjera të rrjetit kompjuterikë.

Është dizajnuar projekti për realizimin e avancimit të pajisjeve të teknologjisë informative të dhomës së serverëve, si: server-të, router-të, switch-të, dhe firewalli. Në fund të vitit 2020 në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Kosovë është proceduar ky projekt, dhe pritet të realizohet brenda këtij viti.

Në aspektin e menaxhimit dhe administrimit, është vazhduar menaxhimi dhe administrimi i të gjitha pajisjeve të rrjetit kompjuterik të Agjencisë – LAN. Ndërsa në aspektin e digjitalizimit të të dhënave, edhe këtë vit, është vazhduar menaxhimi dhe azhurnimi i të dhënave elektronike të punës së Agjencisë, sa i përket të dhënave të deklarimit të pasurisë.

Përmes sistemit elektronikë të deklarimit dhe regjistrimit të pasurisë – SDRP është bërë ruajtja elektronike e të dhënave, dhe më pastaj gjenerimi automatik i regjistrave të deklarimit të pasurisë, të cilët pastaj janë publikuar në ueb faqen e agjencisë në formatin "pdf", dhe këto deklarime gjenden në linkun: https://akk-ks.org/deklarimi_i_pasuris/171/deklarimet/171

Përveç tjerash, përmes këtij sistemi është realizuar edhe hedhja e shortit për të gjithë zyrtarët e lartë publikë të cilët kanë bërë deklarimin e pasurisë në vitin 2020, ku përmes këtij procesi të hapur dhe transparent është përpiluar lista e deklaruesve nga vetë sistemi, dhe pastaj nga ajo

listë është përzgjedhur një numër i rastit, i cili numër është zgjedhur nga një gazetar prezent në sallë gjatë këtij procesi. Pastaj sistemi SDRP duke marr çdo të pestin zyrtar nga lista duke filluar nga numri i përzgjedhur i rastit ka krijuar një listë të re, e njohur si lista e kontrollit të plotë të deklarimit të pasurisë me zyrtarët e lartë publik, të cilët iu kanë nënshtruar procesit të kontrollit të plotë të deklarimit të pasurisë.

Për të avancuar më tepër në menaxhimin e të dhënave elektronike të Agjencisë, në bashkëpunim me UNDP-në, kemi vazhduar me zhvillimin e platformës për deklarimin online të pasurisë, e cila është në zhvillim e sipër, dhe pritet të bëhet implementimi i saj brenda vitit 2021. Ky projekt, në zhvillim e sipër do të mundësoj deklarimin online të pasurisë dhe publikimin e hapur të të dhënave "Open Data". Gjatë zhvillimit të këtij projekti, nga ana jonë është dhënë kontribut i madh në aspektin e përcaktimit të modaliteteve të funksionimit të tij, si në proceset e punës dhe funksionimit të moduleve të tij, ashtu edhe në aspektin teknik të zhvillimit të tij. Ndërsa UNDP-ja ka mbuluar të gjitha shpenzimet financiare në zhvillimin dhe implementimin e tij.

Arkiva

Zyra e Arkivës në vitin 2020, librin e protokollit (regjistrimit të shkresave) e ka përmbyllur me numrin rendor 06-01-3039 (tre mijë e tridhjetë e nëntë) të datës, 31.12.2020.

Gjatë vitit 2020 janë përdor dy libra të protokollit:

- Libri i parë ka filluar me numrin 02-01-2020 të datës, 06.01.2020 dhe ka përfunduar me numrin rendor 02-1710-20 (njëmijë e shtatëqind e dhjetë) të datës, 19.08.2020, si dhe
- Libri i dytë i protokollit ka filluar nga numri 06-1711-20 (njëmijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) të datës, 20.08.2020 dhe ka përfunduar me numrin rendor 06-01-3039 (tremijë e tridhjetë e nëntë) të datës, 31.12.2020.

Të gjitha shkresat e pranuara në zyrën e arkivës, shkresat e nënshkruara dhe të protokolluara nga Drejtori i Agjencisë pas regjistrimit në librin e protokollit përcillen në njësinë organizative, te Drejtori i Departamentit, Udhëheqësi i Divizionit dhe zyrtari përkatës për procedurë të mëtutjeshme.

Zyra e arkivës në bashkëpunim me Departamentin e Parandalimit të Konfliktit të Interesit, si dhe Departamentin e Parandalimit të Korrupsionit gjatë vitit 2020, ka përcjellë për ueb faqe të agjencisë opinionet e Divizionit të Parandalimit të Korrupsionit në Prokurimin Publik, vendimet e Divizionit të Parandalimit të Konfliktit të Interesit në rastet kur ekziston konflikt interesi dhe në rastet kur kemi të bëjmë me mbyllje të konfliktit të interesit.

Agjencia kundër Korrupsionit përmes zyrës së arkivës gjatë vitit 2020 ka pranuar dokumentacion që nuk ka të bëjë me punën e Agjencisë. Pas konsultimit me zyrtaret e departamenteve brenda Agjencisë, dokumentacioni i pranuar është rikthyer me vëllim të njëjtë nëpër institucionin përkatës me shkresë përcjellëse, ashtu siç janë pranuar.

Libri i protokollit për regjistrimin e Formularëve të Deklarimit të Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik është menaxhuar nga zyrtarët e Divizionit të Mbikëqyrjes së Pasurisë.

Është bërë edhe transferimi i lëndëve nga një Departament në Departamentin tjetër, sipas natyrës së lëndës.

Sipas rekomandimit të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, me Nr. protokolli 4898/16, datës 28.12.2016, Agjencia kundër Korrupsionit është e obliguar të mbaj një kopje origjinale të të gjitha shkresave, të cilat dalin nga Agjencia nëpër institucione tjera të Republikës së Kosovës.

Shkresat e Departamentit për Luftimin e Korrupsionit pas nënshkrimit nga Drejtori i Agjencisë, të regjistruara me nr.02 janë skanuar dhe arkivuar sipas numrit rendor të protokollit.

Duke u bazuar në Rregulloren nr. 02/2014 të Punës për Organizimin, Funksionimin dhe Menaxhimin e Arkivit të Agjencisë sipas shenjave të klasifikimit, shkresat të cilat i ka pranuar Agjencia nga institucionet tjera për Departamentin për Luftimin e Korrupsionit janë protokolluar me numër;

- 02-01- Divizioni për Hetime dhe Analiza;
- 02-02- Divizioni për Hetime dhe Strategji;
- 02-03- Divizioni për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Hetimeve ,të cilat pastaj janë dorëzuar njësisë përkatëse organizative;

Duke u bazuar në deklaratën për ruajtjen e konfidencialitetit të Agjencisë, zyra e arkivës nuk ka të skanuara dhe të ruajtura kallëzimet penale por ato përcillen në njësinë organizative përkatëse të nënshkruar nga udhëheqësit ose drejtori i njësisë. Gjithashtu edhe vendimet për mbyllje rasti të këtij departamenti gjenden vetëm me një kopje në origjinale, pasi që ato ruhen brenda Agjencisë.

Shkresat e Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit të nënshkruara nga Drejtori i Agjencisë janë protokolluar me numër 03, siç janë: kërkesat për sqarim rreth deklarimit të pasurisë, kërkesat për dokumentacion, kthim dokumentacioni, opinionet nga Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik.

Shkresat të cilat janë pranuar nga zyra e arkivës për Departamentin për Parandalimin e Korrupsionit, janë protokolluar sipas shenjave të klasifikimit të Agjencisë, me numër;

- 03-01-Divizioni për Mbikëqyrjen e Pasurisë,
- 03-03- Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik.

Shkresat e Divizionit të Parandalimit të Korrupsionit në Prokurimin Publik të cilat duhet t'iu dërgohen institucioneve tjera të Republikës së Kosovës janë menaxhuar nga vetë divizioni siç janë: kërkesat për dokumentacion, njoftimet për vëzhgim. Opinionet për publikim në ueb faqe të Agjencisë të cilat janë përcjell nga zyra e arkivës, me kërkesën e zyrtarëve të divizionit të lartpërmendur prej datës 27.10.2020, janë përcjell për ueb faqe të Agjencisë përmes këtij divizioni.

Duke u bazuar në vendimin e Drejtorit të Agjencisë, më numër protokolli 01-3048/2010, të datës 01.09.2010, Zyra e Arkivës mirëmban edhe paratë e imëta të Agjencisë – PTKSH-in.

Në vitin 2020 AKK ka qenë e ngarkuar me para të imta në shumë prej 2000 euro (dy mijë euro). Nga kjo shumë Agjencia kundër Korrupsionit ka shpenzuar gjithsej 1544.79 (njëmijë e pesë qind e dyzet e katër euro- e shtatë dhjete e nëntë cent) dhe janë kthyer 455.21 (katërqind e pesëdhjete e pesë euro e njëzet e një cent). Mbyllja e avancit të PTKSH-it është bërë me datën, 24.12.2020.

Sipas vendimit me Nr. protokolli 01-1006-1/, të datës 17.05.2019, identifikimi me shenja klasifikuese për Departamentin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përcaktohet me shenjën klasifikuese 06.

- 06-01- Divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për zyrtarët e lartë dhe Autoritete Përgjegjëse, si dhe
- 06-02- Divizioni për Parandalimin e Autoriteteve Përgjegjëse dhe persona zyrtarë.

Vendimet për rastet kur kemi të bëjmë me ekzistimin e konfliktit të interesit, apo në rastet kur kemi të bëjmë me mbylljen e konfliktit të interesit, përmes zyrës së arkivës dërgohen për publikim në ueb faqe të Agjencisë, si dhe përmes postës fizike te zyrtari i lartë publik.

KOMUNIKIMI PUBLIK

Në përmbushje të mandatit të saj ligjor, për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, AKK ka pranuar informata dhe ka zhvilluar komunikimin me qytetarët dhe grupe të tjera të interesit edhe nëpërmjet platformës elektronike RAPORTO KORRUPSIONIN, adresës elektronike info@akk-ks.org si dhe numrin e telefonit +383 (0) 200 10 715.

Në adresën elektronike info@akk-ks.org, janë pranuar gjithsej 8119 emaila, të adresuar nga qytetarët dhe grupet e interesit, lidhur me deklarimin e pasurisë parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, parandalimin e konfliktit të interesit dhe informata të tjera relevante.

Marr për bazë rekomandimet e institucioneve të Kosovës gjatë vitit 2020, për respektimin e masave të përgjithshme dhe specifike nga pandemia COVID-19, adresa elektronike info@akk-ks.org ka shërbyer si adresë për deklarimin e vjetor të pasurisë dhe deklarimin me rastin e marrjes dhe dorëzimit të detyrës zyrtare të subjekteve deklaruese. Nga gjithsej 8119 njoftime të pranuara, 7746 informata janë pranuar nga subjektet deklaruese lidhur me deklarimin e pasurisë, 139 njoftime lidhur me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, 158 njoftime për parandalimin e konfliktit të interesit. Pjesa tjetër e njoftime (76) janë adresuar nga institucionet dhe grupet e të tjera të interesit në formë njoftimesh, ftesa dhe informata të tjera.



Figura 3. Informatat e pranuara në adresën elektronike info@akk-ks.org

Gjatë vitit 2020, AKK ka pranuar nga mediat e shkruara dhe elektronike 75 pyetje të cilat janë adresuar për të kërkuar informata në raport me mandatin e AKK-së që lidhen me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, procesin e hetimeve, deklarimin e pasurisë, çështjet e parandalimit të konfliktit të interesit si dhe interesime për informata lidhur me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në prokurimin publik. Të gjitha informatat e ofruara për mediat e interesuara, janë adresuar përkitazi me mandatin dhe fushëveprimin ligjor të AKK.

Në periudhën raportuese janar- dhjetor, AKK, ka dërguar në media 13 informata që lidhen me fushëveprimin e AKK-së në raport me aktivitetet e Drejtorit të Agjencisë, informatat për procesin e deklarimit të pasurisë dhe aktivitete tjera të realizuara sipas planit të punës të AKK.



Figura 4. Komunikimi me media

Zbatimi i ligjit për qasje në dokumente publike

AKK, gjatë periudhës janar – dhjetor 2020, ka pranuar 3 kërkesa për qasje në dokumente publike të paraqitura nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe media, ndërsa interesimet kanë qenë të orientuara në sigurimin e informatave për Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve (2) dhe sigurimin e informatave për vendimet që lidhen me mandatin e AKK-së (1).



Figura 5. Zbatimi i ligjit për qasje në dokumente publike

Monitorimi i mediave

Interesimet e mediave për të trajtuar situatat për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit janë evidentuar në grafikun e mëposhtëm ku nga informatat e publikuara nga mediat e shkruara dhe elektronike janë evidentuar gjithsej 521 artikuj të publikuar në Radio televizione, portale, informata dhe artikuj të publikuar në mediat e shkruara.

Nga 521 artikuj të publikuar nga mediat e shkruara dhe elektronike, 229 artikuj, janë publikuar me informata që lidhen direkt me mandatin dhe fushëveprimin ligjor të AKK-së dhe nga informatat e siguruara nga Agjencia nëpërmjet intervistave, deklaratave dhe përgjigjeve të dërguara në media në mënyrë elektronike.

Dy figurat në vijim paraqesin në mënyrë grafike numrin e shkrimeve të raportuara për korrupsion, dhe atyre për punën e Agjencisë, nëpër muaj për vitin 2020.



Figura 6. Shkrimet për korrupsion në mediat elektronike dhe te shkruara sipas muajve gjatë vitit 2020



Figura 7. Numri i shkrimeve i të gjitha mediave elektronike dhe të shkruara për mandatin dhe fushëveprimin e Agjencisë - 2020

Informatat lidhur me fushëveprimin dhe aktivitet e Agjencisë përgjatë vitit 2020, janë publikuar edhe në ueb-faqen e AKK-së ku gjatë periudhës janar-dhjetor janë publikuar informata që përfshijnë aktivitetet ditore të Agjencisë, opinionet, vendimet dhe shkresat tjera për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, rasteve të parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik si dhe informata dhe dokumente të tjera në interes të opinionit publik. Gjatë kësaj periudhe në ëeb faqen e AKK-së janë publikuar 22 informata nga aktivitetet ditore të Agjencisë, 2 dokumente për fushë veprimtarinë e AKK-së, raporti vjetor i punës së Agjencisë për vitin 2020 si dhe vendimet dhe opinionet për rastet e trajtuara nga AKK.

MENAXHIMI I PERSONELIT

Në mbështetje të Rregullores për Sistematizimin e vendeve të punës, në AKK, Menaxheri i personelit është përgjegjës për aktivitetet që kanë të bëjnë me detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrave të Personelit. Në këtë kontekst, kjo zyrë në AKK ka vazhduar me aktivitetet dhe përgjegjësitë e rregullta, duke filluar nga mirëmbajtja e Sistemit të Menaxhimit të vijueshmërisë në punë, përditësimi dhe regjistrimi i pushimeve vjetore, mjekësore, dhe llojet e pushimeve të tjera. Gjithashtu, janë përgatitur listat e pagave në baza mujore dhe ndryshimet e nevojshme në këto lista.

Gjatë vitit 2020 zyra e personelit ka vazhduar aktivitetet e përditshme duke filluar nga plani i personelit, menaxhimi i disa sistemeve që lidhen direkt me përgjegjësit e zyrës së personelit si SIMBNJ-ë, SVMP dhe sistemi i menaxhimit të Pagave.

Është bëre përditësimi i të dhënave të nevojshme për të gjitha këto sisteme, raporte, po ashtu edhe ndryshimet që lidhën me pagat e zyrtarëve të AKK-së.

Gjatë vitit 2020 kemi pasur tri avancime përmes konkursit të brendshëm të Agjencisë kundër Korrupsionit.

Në mbështetje të dispozitave për avancim, stafi i AKK-së ka marr pjesë në trajnime dhe udhëtime të ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës. Lista e të gjitha udhëtimeve dhe trajnimeve gjenden në *Shtojcën 5.*

Prokurimi

Agjencia kundër Korrupsionit si Autoritet kontraktues gjatë vitit 2020, përmes Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP), ka zhvilluar aktivitete të prokurimit sipas llojeve të prokurimit furnizim dhe shërbime. Në mënyrë tabelore aktivitetet e prokurimit janë si në vijim.

Tabela 14. Pasqyra e aktiviteteve të Prokurimit Publik

Procedura	Lloji i aktivitetit të prokurimit	Numri i aktiviteteve	Çmimi i përafërt i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.
Furnizim, shërbime	Kuotim Çmimi	4	8,500.00 €
Furnizim, shërbime	Vlerë minimale	4	3,204.48 €
Furnizim	Procedurë e Hapur	/	/
Gjithsej	-	8	11,704.48 €

Shënim:

Nga data 07.06.2017, të gjitha aktivitetet e prokurimit të Agjencive të Pavarura që janë në kuadër të Kuvendit të Republikës së Kosovës e të cilat janë të shënuara në memorandum shpjegues zhvillohen nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, neni 21/A paragrafi 2 i të Ligjit nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 04/L-037, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Të gjitha kontratat tjera për furnizime, shërbime ose punë të tjera janë të centralizuara dhe të udhëhequra nga ana e Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe disa janë në vlerë të përafërt për shumë institucione.

Vlen të ceket se disa aktivitete të prokurimit të iniciuara vitin e kaluar kanë dështuar për arsye të tejkalimit të buxhetit apo për shkak të ankesave në OSHP, janë anuluar nga AQP.

BUXHETI (*përmbledhje e zhvillimeve kryesore*)

AKK ka përgatitur kërkesat për ndarje buxhetore në duke u bazuar në vlerësimet e brendshme nga njësitë organizative. Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës kanë aprovuar kërkesën duke ndarë buxhetin për vitin 2020.

Ndarjet buxhetore për periudhën Janar - Dhjetor 2020 janë në shumën prej 572,009.00 €.

Tabela në vazhdim pasqyron ndarjet buxhetore sipas kategorive ekonomike.

Tabela 15. Pasqyra e ndarjes buxhetore sipas kategorive ekonomike

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti i aprovuar (fillestar)	Buxheti i rishikuar (final)
1	Paga dhe Shtesa	431,564.00	406,582.86
2	Mallra dhe Shërbime	131,963.00	88,377.63
3	Shpenzime Komunale	8,500.00	3,375.58
	Totali	572,009.00	498,336.07

Pas rishikimit, buxheti fillestar ka pësuar ndryshime. Në të gjitha kategoritë e shpenzimeve fondet janë zvogëluar, por që nuk kanë pasur ndonjë efekt negativ.

Tabela në vijim pasqyron ndarjet buxhetore dhe shpenzimet, pas rishikimit të buxhetit.

Tabela 16. Pasqyra e shpenzimeve pas rishikimit të buxhetit

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti	Shpenzimet	% e realizimit
1	Paga dhe Shtesa	406,582.86	406,582.86	100
2	Mallra dhe Shërbime	88,377.63	58,232.70	65.89
3	Shpenzime Komunale	3,375.58	2,788.69	82.61
	Totali	498,336.07	467,604.25	93.83

Buxheti përfundimtar për vitin 2020 ka qenë 498,336.07 €. Nga kjo shumë janë shpenzuar gjithsej 467,604.25 € apo shprehur në përqindje 93.83% të buxhetit.

Buxheti përfundimtar për kategorinë Paga dhe Mëditje është realizuar në masën 100%, ndërsa për kategorinë Mallra dhe Shërbime është shpenzuar në masën 65.89%. Buxheti në kategorinë Shpenzime Komunale është realizuar në masën 82.61%.

Nga buxheti i shpenzuar, pjesën më të madhe të buxhetit e kanë pagat dhe shtesat me 81.59%.

Raporti Financiar për Vitin 2020 i detajuar është i bashkangjitur si Aneks i veçantë në Raportin Vjetor të Punës së AKK-së për vitin 2020.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET TJERA QË KANË PËR MISION LUFTIMIN DHE PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

AKK ka vazhduar në drejtim të avancimit të bashkëpunimit të ndërsjellë me institucionet vendore dhe ndërkombëtare të cilat për mision kanë luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Megjithatë bashkëpunimi ndër institucional në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit vazhdon të mbetet një sfidë.

Bashkëpunimi me Prokuroritë sa i përket informatave kthyese tek Agjencia për procedimin e mëtutjeshëm dhe vendimin final lidhur me rastet e përcjella është avancuar dhe ka qenë i qëndrueshëm. Në të gjitha rastet e përcjella AKK ka pranuar njoftime me shkrim nga Prokuroria.

Brenda afateve të arsyeshme kohore AKK ka pranuar konfirmime nga ana e Prokurorive dhe Policisë së Kosovës nëse për rastet e njëjta të raportuara në AKK është iniciuar dhe zhvillohet procedura penale në mënyrë që rastet e njëjta të mos hetohen në të njëjtën kohë nga dy institucione dhe të mos zhvillohen dy procedura të ndara. AKK gjatë gjithë vitit, në baza mujore, ka shkëmbyer informacione me Prokuroritë Themelore rreth numrit të rasteve të përcjella në shërbim të harmonizimit të statistikave.

AKK ka bashkëpunuar ngushtë me prokurorët kontaktues të caktuar nga Prokuroritë si rezultat i punëtorisë së përbashkët e realizuar më parë, si dhe në shumë raste janë kontaktuar edhe prokurorët tjerë.

Brenda kompetencave ligjore AKK ka shkëmbyer informacione dhe dokumentacione me të gjitha institucionet tjera që kanë për mision parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Në këtë kuptim AKK ka ofruar informacione për institucionet kompetente lidhur me verifikimin e të kaluarës së personave të caktuar.

AKK ka bashkëpunuar me të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit dhe institucionet tjera relevante me qëllim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit në Kosovë.

Në aspektin rajonal dhe ndërkombëtarë, AKK ka vazhduar komunikimin dhe bashkëpunimin me të gjitha Agjencitë dhe Autoritetet homologe në rajon.

Traktati Ndërkombëtar për Shkëmbimin e të Dhënave për Verifikimin e Deklaratës së Pasurive

Si rezultat i këtij bashkëpunimi, sidomos me Iniciativën Rajonale Kundër Korrupsionit – RAI, është finalizuar drafti i Traktatit Ndërkombëtar për Shkëmbimin e të Dhënave për Verifikimin e Deklaratës së Pasurive. Ky Traktatit ishte planifikuar të nënshkruhej nga shtetet anëtarë të këtij traktati, duke përfshirë dhe Kosovën, më datën 24 mars 2020 në in Palais Niederösterreich, Vienna, sipas ftesës së dërguar nga Ministri Federal i Republikës së Austrisë për Punë Evropiane dhe Ndërkombëtare. Ftesa e drejtuar tek Ministri i atëhershëm i Punëve të Jashtme të Kosovës, për të cilën është njoftuar edhe AKK. Takimi i 24 marsit ishte shtyrë për shkak të COVID19. Ky Traktat nuk është nënshkruar ende.

Marrëveshja e Bashkëpunimit me AKK-së dhe Komisionit Kundër Korrupsion dhe Konfiskimin e Pasurive të Paligjshme të Republikës së Bullgarisë

Agjencia Kundër Korrupsionit më datën 21 dhjetor 2020 përmes mjeteve të komunikimit elektronik ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimin me Komisionit Kundër Korrupsion dhe Konfiskimin e Pasurive të Paligjshme të Republikës së Bullgarisë.

Nënshkrimi i kësaj Marrëveshje është bërë si rezultat i nevojës së zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimit të ndërsjellë midis autoriteteve kundër-korrupsion, me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të efikasitetit të luftës kundër korrupsionit përmes shkëmbimit të përvojës dhe praktikave të mira, dhe duke njohur rolin kryesor të Komisionit Kundër Korrupsion dhe Konfiskimin e Pasurive të Paligjshme të Republikës së Bullgarisë dhe Agjencisë Kundër Korrupsion në vendet përkatëse dhe përvojën që mund të jetë me përfitim të ndërsjellë.

Ashtu siç përcaktohet dhe me dispozitat e kësaj Marrëveshje, në kuadër të këtij bashkëpunimi, palët nënshkruese synojnë të punojnë drejt sigurimit të bashkëpunimit të ndërsjellë teknik dhe shkëmbimit të përvojës, qoftë drejtpërdrejt ose përmes institucioneve ose organizatave të tjera, nëse këto të fundit rezultojnë të jenë më praktike dhe më efektive, në një fushë të gjerë çështjesh lidhur me parandalimin e korrupsionit, sistemin e integritetit dhe qeverisjes së mirë.

Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimin mes AKK dhe Iniciativës Rajonale Kundër Korrupsionit – RAI

Agjencia Kundër Korrupsionit përmes mjeteve të komunikimit elektronik ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimin me Iniciativën Rajonale Kundër Korrupsionit.

Ashtu siç përcaktohet dhe me dispozitat e kësaj Marrëveshje, qëllimi i këtij Memorandumi është të sigurojë bashkëpunim në mes të Pjesëmarrësve në fusha me interes të përbashkët dhe të përcaktojë kornizën, parimet dhe modalitetet e këtij bashkëpunimi, me synimin që të shfrytëzoj plotësisht dhe me efikasitet një bashkëpunim të tillë.

Nënshkrimi i kësaj Marrëveshje është bërë duke pasur parasysh mandatin e Agjencisë Kundër Korrupsionit të Kosovës, rolit dhe rëndësisë së saj në zbatimin e sinjalizimit si një mjet për të luftuar korrupsionin si dhe duke i njohur përpjekjet më të gjera që Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsion po i investon në luftimin e korrupsionit dhe promovimin e qeverisjes së mirë në të gjitha aspektet e saj, duke përfshirë përmirësimin e sundimit të ligjit në Evropën Juglindore (EJL), përmirësimin e efikasitetit, integritetit dhe llogaridhënies së sektorit publik, që të gjitha këto janë thelbësore për mirëqenien, stabilitetin dhe prosperitetin e EJL-së;

Kosova është një ndër përfitueset e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian 'Ndërpreje heshtjen: Përmirësimi i Politikave dhe Kulturës së Sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavinë' dhe do të realizohet për periudhën gjatë periudhës Prill 2020 deri në Prill 2023, të implementuar nga Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit për përmirësimin e procesit të sinjalizimit në EJL.

AKK aktualisht përkrahet nga dy projekte në të cilat është përfitues direkt: 1. Projekti kundër Krimit Ekonomik – PECK III i Bashkimit Evropian dhe Zyrës së BE-së në Kosovë implementuar nga Këshilli i Evropës. Dhe 2. Projekti Përkrahja e Përpjekje Kundër Korrupsion – SAEK III (Supprt the Anti-Corruption Efforts in Kosovo II) përkrahur nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe Agjencia Ndërkombëtare e Suedisë për Zhvillim dhe Bashkëpunim. AKK gjithashtu përkrahet nga OPDAT, nga Byroja për çështje ndërkombëtare të narkotikëve dhe zbatimit të ligjit (INL) dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë.

ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

Për vitin paraprak, me rastin e kontrollit financiar, vlerësimi i përgjithshëm për pasqyrat financiare ka qenë pozitiv dhe në të gjitha aspektet materiale kanë pasur prezantim të drejtë dhe të vërtetë.

Për Agjencinë është dhënë një rekomandim. Në vijim është paraqitur në mënyrë tabelore rekomandimi dhe veprimi i menaxhmentit të AKK-së, për zbatimin e tij.

Tabela 17. Pasqyra e adresimit të rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Nr.	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit
1	Rekomandimi 1 Drejtori duhet t'i siguroj që të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	Nga personat përgjegjës është kërkuar që të ndërmerren masat e nevojshme që pasuria kapitale të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin E- Pasuria.	Nga zyrtari i pasurisë dhe zyrtari i pranimit të mallit janë ndërmarrë veprime të menjëhershme dhe janë regjistruar të gjitha pasuritë në regjistrat përkatës.	I plotësuar

MËSIMET DHE REKOMANDIMET

AKK konsideron se viti 2020 ka qenë i përcjellë me aktivitete të shumta përmes të cilave AKK ka realizuar Planin e Punës për vitin 20 konform kompetencave të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi fushat që lidhet me parandalimin, hetimin dhe luftimin e korrupsionit, prejardhjes dhe deklarimit të pasurisë, parandalimit të konfliktit të interesit, mbrojtjes së sinjalizuesve, deklarimit të dhuratave, parandalimit të korrupsionit në aktivitetet e prokurimit publik, dhe aspektet tjera në fushën e kundër korrupsionit. Sidoqoftë, përkundër përkushtimit maksimal në përmbushjen e mandatit, AKK konsideron se situata me pandeminë COVID-19, masat e Qeverisë së miratuara për kufizim të stafit, kufizim të lëvizjes, dhe koordinimi i punëve, në disa raste dhe me orar të shkurtuar, ka ndikuar edhe në mbarëvajtjen e punës së AKK-së. Megjithatë, falë kujdesit, AKK ka arritur që të menaxhoj mirë dhe t'i përshtatet rrethanave, duke filluar me përdorimin e teknologjisë informative, duke i zëvendësuar takimet e rregullta me ato online (virtuale). Të gjithë këto kanë rezultuar në progresin e kënaqshëm në realizimin e detyrave të AKK-së, dhe arritjen e rezultateve si të paraqitura në këtë raport.

Bazuar në punën dhe rezultatet e arritura gjatë këtij viti, AKK rekomandon që fokusi të jetë në:

- ⇒ Zbatimin e plotë të legjislacionit në fuqi në të gjitha fushat që kanë të bëjnë me parandalimin, hetimin dhe luftimin e korrupsionit;
  - ✓ Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik;
  - ✓ Mbrojtjen e Sinjalizuesve, si dhe miratimin e të gjitha akteve nën-ligjore për caktimi, fuqizimi dhe trajnimi i të gjithë Zyrtarëve Përgjegjës për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në të gjitha institucionet publike dhe private;
  - ✓ vazhdimin e procedurës së miratimit të Ligjit të Ri për Agjencinë – Draft-Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit sipas Agjendës Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
  - ✓ vazhdimin e procedurës së miratimit të Ligjit të Ri për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar sipas Agjendës Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- ⇒ Vazhdimin e procedurës së miratimit të draftit të ri të Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit për periudhën 2022 – 2024;
- ⇒ Zhvillimin dhe funksionalizimin e platformës online të deklarimit të pasurisë dhe platformës për menaxhimin e rasteve të Agjencisë;
- ⇒ Avancimin e digjitalizimit të databazës së Agjencisë dhe digjitalizimin e ofrimit të shërbimeve për palët në Agjenci;
- ⇒ Zhvillimin e Metodologjive të përbashkëta: Metodologjisë së përbashkët Hetuese; Metodologjisë së Vlerësimit të Legjislacionit (Corruption Proofing Methodology) dhe Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut nga Korrupsioni;

- ⇒ Hartimi, miratimin, zbatimin dhe monitorimi i duhur i Planeve të Integritetit të të gjitha Institucioneve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale;
- ⇒ Fuqizimin e mëtejmë të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile në fushën kundër korrupsion dhe medie.

PËRFUNDIMI

Ashtu siç është theksuar dhe më lartë, përkundër të gjitha sfidave gjatë përballjes me Covid-19, AKK përkushtim të plotë realizuar detyrat konform mandatit dhe kompetencave në fushën e hetimit dhe zbulimit të rasteve me natyrë të korrupsionit. AKK veçanërisht ka punuar në:

- ⇒ Hetimin e Korrupsionit përmes zhvillimit të procedurave të hetimit paraprak të rasteve të dyshimit për korrupsion; analizimit të të dhënave statistikore dhe të dhënave të tjera për gjendjen e korrupsionit në Kosovë; mbrojtjes së sinjalizuesve sipas ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve si dhe raportimit për zbatimin e detyrave të Agjencisë të përcaktuara nga dokumentet tjera strategjike;
- ⇒ Parandalimin e Korrupsionit përmes mbikëqyrjes së pasurisë; mbikëqyrjes së dhuratave dhe parandalimit e korrupsionit në prokurimin publik dhe korrupsionit në përgjithësi;
- ⇒ Parandalimin e Konfliktit të Interesit përmes për parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik gjatë ushtrimit të funksionit publik; bashkëpunimit me Autoritetet Përgjegjëse; analizimit dhe trajtimit të rasteve të konfliktit të interesit; pranimit të raporteve vjetore nga Autoritetet Përgjegjëse; ofrimit të asistencës profesionale dhe këshillave për institucionet tjera në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit;
- ⇒ Organizimit të punëve të përgjithshme përmes menaxhimit dhe përkujdesjes për burimet materiale, ofrimin e shërbimeve administrative, menaxhimin e financave dhe buxhetit si dhe logjistikën e Agjencisë; ofrimit të mbështetjes profesionale, bashkëpunimit, informimit dhe koordinimit të aktiviteteve të informimit si dhe menaxhimit të personelit, arkivës dhe prokurimit brenda AKK-së.

AKK në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, konkretisht me Komisionin për Legjislacion të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë, ka përcaktuar qartë prioritet në drejtim të zbatimin e kornizës ligjore me qëllim - luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, promovimin e transparencës dhe forcimin e integritetit institucional, si dhe përpjekjeve dhe përkushtimit për krijimin e një ambienti shoqëror të lirë nga korrupsioni.

Korniza ligjore bazë e AKK-së është në procedurë të ndryshimit dhe plotësimit. Si rezultat draft-Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit (Draft-Ligji për Parandalimin e Korrupsionit) dhe draft-Ligji për Deklarimin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik dhe personave të tjerë janë kanë qenë pjesë e diskutimit në Grupet Punuese. Draft-Ligji për Parandalimin e Korrupsioni me sukses është përfunduar nga grupi punues, është finalizuar nga Ministria e Drejtësisë pas mbarimit të procedurave të konsultimit paraprak dhe konsultimeve publike.

Prioritet dhe sfidë qenësore e Agjencisë mbetet vazhdimi i përmbushjes së plotë të mandatit të Agjencisë në bazë të kompetencave të përcaktuar me dispozitat ligjore në fuqi në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik, deklarimit të pasurisë dhe mbrojtjes së sinjalizuesve. Sfidë për Agjencinë ka qenë nderimi i Qeverive, shpërbërja e Kuvendit. Kjo ka reflektuar në mos procedimin e të dy draft-ligjeve - draft-Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit (Draft-Ligji për Parandalimin e Korrupsionit) dhe draft-Ligji për Deklarimin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik – për miratim në Qeveri

dhe në Kuvend. Gjithashtu, për arsye të njëjtë nuk është aprovuar Strategjia Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit, përkundër miratimit në Qeveri.

Prioritetet dhe sfidat për AKK janë:

1. Zbatimi i kornizës ligjore kundër korrupsion,
    a. Ligji i Agjencisë Kundër Korrupsion
    b. Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave;
    c. Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik;
    d. Ligji Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve. Miratimi i Rregullores për procedimin e pranimit dhe trajtimit të rasteve në Agjencinë Kundër Korrupsionit;
2. Vazhdimi i procedurave të plotësimit dhe ndryshimit të
    a. Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit (Draft-Ligji për Parandalimin e Korrupsionit) sipas Agjendës Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës; dhe
    b. Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtar sipas Agjendës Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
3. Rishikimi dhe ndryshimi i organizimit të brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës në AKK në aspektin organizativ dhe operacional, konform ndryshimeve legjislative;
4. Shtimi i burimeve njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve administrative në avancimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit të Agjencisë; avancimin e stafit në lidhje me zhvillimin e procedurës së hetimeve paraprake, trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, deklarimit të pasurisë, mbrojtjes së sinjalizuesve, monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik, bashkëpunimin ndërinstitucional, dhe çështje të tjera;
5. Hartimi i Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit 2022 – 2024 dhe Planit të Veprimit të saj, si dhe fillimi i zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit.
6. Zhvillimin dhe funksionalizimin e platformës online të deklarimit të pasurisë dhe platformës për menaxhimin e rasteve të Agjencisë;
7. Avancimin e digjitalizimit të databazës së Agjencisë dhe digjitalizimin e ofrimit të shërbimeve për palët në Agjenci;
8. Zhvillimi i Metodologjive të përbashkëta: Metodologjisë së përbashkët Hetuese; Metodologjisë së Vlerësimit të Legjislacionit (Corruption Proofing Methodology); Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut nga Korrupsionit;

9. Hartimi, miratimin, zbatimin dhe monitorimi i duhur i Planeve të Integritetit të të gjitha Institucioneve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale;
10. Vazhdim dhe fuqizimi bashkëpunimit me mekanizmat institucional përgjegjës për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë;
11. Edukimi i zyrtarëve dhe institucioneve shkollore;
12. Organizimi i takimeve të përbashkëta me akterë vendorë kundër - korrupsion (Polici, Prokurori, Gjykata) për adresimin e çështjeve të ndryshme dhe përmirësimin e komunikimit edhe më tej;
13. Bashkëpunimi ndërkombëtarë, anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare, bashkëpunimi me vendet ku AKK ka nënshkruar Memorandume Bashkëpunimi dhe ri-shikimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit ndërinstitucional.
14. Bashkëpunimi i mëtejmë të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile në fushën kundër korrupsion dhe medie.

SHTOJCAT

Shtojca I - Organogrami



Shtojca II

Tabela 18. Lista e zyrtarëve që nuk kanë deklaruar pasurinë

Nr.	Emri, Mbiemri	Pozita	Institucioni
1.	Jeffery Butel	Anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë/Agjencia e Kosovës për Akreditim	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - MASHTI
2.	Magdalena Ziolo	Anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë/Agjencia e Kosovës për Akreditim	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - MASHTI
3.	Herbert Amato	Anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë/Agjencia e Kosovës për Akreditim	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - MASHTI
4.	Violeta Hamiti	Këshilltare Politike	Ministria e Drejtësisë - MD
5.	Shuqeri Musliu	Udhëheqës i Njësisë për Politika dhe monitorim te NP	Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike - MEPTINIS
6.	Gresa Maliqi	Këshilli Drejtues i Librit	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - MKRS
7.	Nuhi Gashi	Këshilli Drejtues i Librit	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - MKRS
8.	Liridon Sadrija	Konsull	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
9.	Zana Rudi	Udhëheqëse e Departamentit për Nato dhe Politika të Sigurisë	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
10.	Kadri Balaj	Konsull	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
11.	Modesta Imeri	Konsull	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
12.	Armend Rushiti	Këshilltar Komunal	Obiliq
13.	Remzi Zeneli	Drejtor i Stacionit të Autobusëve	Podujevë
14.	Besnik Mujeci	Këshilltar Komunal	Prishtinë
15.	Sokol Berisha	Këshilltar Komunal	Prishtinë
16.	Yll Bogaj	Këshilltar Komunal	Prishtinë
17.	Anita Morina-Saraçi	Anëtar i Bordit në Stacionin e Autobusëve	Prishtinë
18.	Diarta Vishesella	Këshilltar Komunal	Shtime
19.	Berat Zuka	Zyrtar Kryesor Financiar	Viti
20.	Ekrem Mustafa	Këshilltar Komunal	Ferizaj
21.	Riza Abdyli	Këshilltar Komunal	Gjilan
22.	Faton Isufi	Drejtor Teknik	"Telekomi I Kosovës" Sh.A
23.	Shkelqim Osmanaj	Anëtar i Bordit të Drejtorëve	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës "INFRAKOS" Sh.A
24.	Nazmi Kelmendi	Anëtar i Bordit të Drejtorëve të N.P."QENDRA MULTIFUNKSIONALE " SH.A	N.P "QENDRA MULTIFUNKSIONALE" Sh.A, MITROVICË
25.	Driton Pruthi	Prokurim	Trepça Sh.A
26.	Naser Rexha	Fabrika e Pajimeve të Procesit	Trepça Sh.A
27.	Mentor Balaj	Auditor	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" SH.A, Prishtinë

Shtojca III

Tabela 19. Lista e zyrtarëve që kanë deklaruar pasurinë pas afatit

Nr.	Emri, Mbiemri	Pozita	Institucioni
1.	Arbër Zaimi	Këshilltar politik i zëvendëskryeministrit të dytë	Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës – ZKM
2.	Lulzim Zeneli	Prorektor për bashkëpunim ndërkombëtar dhe kërkime shkencore	Universiteti i Gjakovës – MASHT
3.	Rozeta Hajdari	Ministre	Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike – MEPTINIS
4.	Arber Rrahmani	Këshilli Drejtues i Librit	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – MKRS
5.	Agim Berisha	Këshilli Drejtues i Librit	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – MKRS
6.	Emin Kabashi	Këshilli Drejtues Biblioteka Kombëtare	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – MKRS
7.	Fisnik Ademi	Këshilli Drejtues i Teatrit Kombëtar	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – MKRS
8.	Ismet Azemi	Këshilli Drejtues I Teatrit Kombëtar	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – MKRS
9.	Jahja Shehu	Këshilli Drejtues I Teatrit Kombëtar	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – MKRS
10.	Adil Olluri	Këshilli Drejtues I Teatrit Kombëtar	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – MKRS
11.	Shasivar Haxhijaj	Këshilli Drejtues AKKV-Shota	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – MKRS
12.	Lulzim Ejupi	Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
13.	Gentiana Azemi	Këshilltare Politike	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
14.	Gëzim Kasapolli	Ambasador	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
15.	Blerim Canaj	Ministër Këshilltar	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
16.	Venera Gjuka	Drejtor	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
17.	Qendresa Bllata	Menaxher prokurimi	Spitali i Përgjithshëm Vushtrri
18.	Frosina Sylejmani	Gjyqtarë i Gjykatës së Apelit	Gjykata e Apelit - Prishtinë / Pristina
19.	Gëzim Pozhegu	Gjyqtarë i Gjykatës Themelore(DKR,DM)	Gjykata Themelore - Gjakovë / Dakovica
20.	Sabit Rama	Gjyqtarë i Gjykatës Themelore (DP)	Gjykata Themelore - Mitrovicë / Mitrovica
21.	Flurije Syla	Gjyqtarë i Gjykatës Themelore (DK)	Gjykata Themelore - Mitrovicë / Mitrovica
22.	Shpëtim Sadiku	Anëtar vendor i Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronave	Agjencia Kosovare per Krahasim dhe Verifikim të Pronës
23.	Nusret Çubreli	Këshilltar Komunal	Mitrovica e Jugut
24.	Xhemile Thaqi Vezgishi	Drejtore	Prizren
25.	Bardhi Avdaj	Këshilltar Komunal	Prizren
26.	Ilir Baldedaj	Këshilltar Komunal	Prizren
27.	Nazife Kokollari	Këshilltar Komunal	Prizren
28.	Dafina Bllaca	Këshilltar Komunal	Prizren
29.	Cenet Sayadi	Këshilltar Komunal	Prizren
30.	Shpresa Tafa	Drejtor i Inovacionit dhe Zhvillim te Projekteve	Shtime
31.	Labinot Beqa	Drejtor i Shëndetësisë dhe Mir.Soc	Shtime
32.	Valentina Halili-Ferati	Këshilltar Komunal	Shtime
33.	Marigona Pajaziti	Këshilltar Komunal	Shtime

34.	Adelina Beqaj	Këshilltar Komunal	Shtime
35.	Arbresha Syla	Këshilltar Komunal	Shtime
36.	Isak Muslija	Këshilltar Komunal	Shtime
37.	Agron Kajtazi	Këshilltar Komunal	Skenderaj
38.	Vehbi Rama	Këshilltar Komunal	Viti
39.	Remzi Salihu	Këshilltar Komunal	Viti
40.	Lulzim Grainca	Këshilltar Komunal	Ferizaj
41.	Gezim Kokollari	Këshilltar Komunal	Ferizaj
42.	Feim Ibrahimi	Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit	Ferizaj
43.	Bekim Jupa	Këshilltar Komunal	Gjakovë
44.	Nazmi Suma	Anëtar bordi i Npl Pastrimi	Hani i Elezit
45.	Rados Repanovic	Këshilltar Komunal	Istog
46.	Saranda Zeqa	Këshilltar Komunal	Klinë
47.	Xhevxhet Berisha	Këshilltar Komunal	Klinë
48.	Saranda Elezaj	Këshilltar Komunal	Klinë
49.	Brahim Mehmetaj	Këshilltar Komunal	Klinë
50.	Shqipnora Dauti	Këshilltar Komunal	Klinë
51.	Njomza Grabanica	Drejtoreshë	Klinë
52.	Avni Gashi	Këshilltar Komunal	Klinë
53.	Valon Krasniqi	Këshilltar Komunal	Malishevë
54.	Luan Morina	UD Kryeshef I Stac. te Autobusëve	Malishevë
55.	Fatmir Gjonbalaj	Zyrtar Kryesor i Prokurimit	"Telekomi I Kosovës" Sh.A
56.	Remzije Tupella	Anëtare I Bordit	"Tregu" Sh. A
57.	Faton Shatmani	Menaxher i Departamentit ligjorë	N.P "Termokos" Sh.A Prishtinë
58.	Saranda Deva Jusufi	Auditor i Brendshëm	NPQ "Aeroporti Gjakovës" Sh. A
59.	Besim Baraliu	Kryeshef Ekzekutiv	KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, Prizren
60.	Muhamet Lama	Drejtor I Departamentit Teknik	KRU "GJAKOVA" Sh.A.-GJAKOVË
61.	Anita Cacaj	UD .Udhëheqëse e Departamentit për Mbështetje të Brendshme	Ndërmarrja Publike Banesore SH.A Prishtinë
62.	Alberton Sahiti	Drejtor Jo Ekzekutiv	Kompania Rajonale e Ujësjellsit "Prishtina"SH.A, Prishtinë
63.	Halil Gashi	Anëtarë i Bordit të Drejtorëve	NH "Ibër Lepenci"

Shtojca IV

Tabela 20. Lista e zyrtarëve që nuk kanë deklaruar pasurinë me arsye

Nr.	Emri, Mbiemri	Pozita	Institucioni	Arsyeja
1.	Sanije Rexha	Ushtrues detyre (UD) Drejtoreshë e Departamentit i Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës	Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike – MEPTINIS	E pezulluar nga puna nga data 17.12.2019
2.	Abedin Mehmeti	Drejtor i Drejtoratit për Prodhimin e Dokumenteve	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	Pushim pa pagesë për shkaqe shëndetësore
3.	Arben Mustafa	Kryeinspektor i Inspektoratit të ARC-së	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike	I pezulluar nga puna nga data 07.02.2020 - paraburgim
4.	Migjen Shala	Këshilltar Komunal	Prishtinë	Arsye shëndetësore
5.	Agim Bregaj	Këshilltar Komunal	Vushtrri	Arsye shëndetësore
6.	Teuta Asllani	UD. Udhëheqëse e Departamentit për Mbështetje të Brendshme	Ndërmarrja Publike Banesore SH.A Prishtinë	Pushim pa pagesë nga data 21.10.2019

Shtojca V

Tabela 21. Tabela e trajnimeve

Nr.	Lloji i Trajnimit	Organizon	Vendi	Data	Emri i zyrtarëve
1.	Konferenca rajonale	KDI	Tiranë	20-22.01.2020	1
2.	Kodi Etik, të drejtat dhe përgjegjësitë në Shërbimin Civil	IKAP	Prishtinë	06-07.02.2020	2
3.	Teknikat e rekrutimit bazuar në meritë	Ambasada Britanike	Prishtinë	12.02.2020	1
4.	Hetime Financiare dhe Kthimi i Aseteve	UNDP	Prishtinë	10-14.02.2020	1
5.	Trajtim Serioz I krimit të Organizuar ne Ballkanin Perëndimor	Zyra e Jashtme dhe Bashkësisë se Mbretërisë[të Bashkuar	Angli	24-26.02.2020	1
6.	Siguria dhe shëndeti në punë	IKAP	Prishtinë	27-28.02.2020	1
7.	Integriteti në Shërbimin Civil	Ministria e Punëve të Jashtme Holandë	Hagë	11-20.03.2020	1
8.	Menaxheret e Personelit	MPB	Prishtinë	14.07.2020	1
9.	Mirësjellja dhe Protokolli Komunikimi Strategjik	Akademia Diplomatike	Prishtinë	2-9.12.2020	1
10.	Public Private Partnerships on Anti-money Laundering and Compliance	UNDP	Prishtinë	09.12.2020	1
11.	Change the culture, change the system	UNDP	Prishtinë	11.12.2020	1
12.	prokurim publik - niveli i avancuar	IKAP-KRPP	Prishtine	11-12.2020	2
13.	Cisco Cybersecurity OPS Training	AUK-TDI	Prishtinë	2020	1